CIVICA MOBILITAS

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЛОКАЛНА САМОУПРАВА
MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE
MINISTRY OF LOCAL SELF GOVERNMENT

CEA
Center for Economic Analyses

DORACAK

për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë

Mirosllav Trajanovski
Marjan Nikollov
Ana Maria Petrovska

janar, 2018

Doracak

për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë

Mirosllav Trajanovski
Marjan Nikollov
Ana Maria Petrovska

janar, 2018

Mbështetur nga granti i CIVICA MOBILITAS

Ky botim u mundësua me mbështetjen e CIVICA MOBILITAS në kuadër të projektit Doracak për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë të zbatuar nga ana e Qendrës për Analiza Ekonomike.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë mendimet e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e CIVICA MOBILITAS.

Autorët tjerë janë të obliguar të paraqesin këtë hulumtim nëse të njejtën e kanë përdorur ose nga e njejta janë informuar për hulumtimet dhe publikimet e tyre.

Informacione të përgjithshme për CEA-në

Adresa:

QENDRA PËR ANALIZA EKONOMIKE (CEA)

Bul. Jane Sandanski 63/3,

1000 Shkup, Maqedoni

tel: + 389 (0) 2 24 44 766

celulari: + 389 71 310 974

Numri Unik i Identifikimit (NUI): 4030003479278

Numri i Regjistrimit: 5763061

Llogaria:
Stopanska Banka SHA Shkup

Numri i Llogarisë: 200000856268559

Faqja e Internetit dhe Posta Elektronike:

www.cea.org.mk

www.mkbudget.org

info@cea.org.mk

PËRMBAJTJE

Përmbajtja 9
1. KORNIZA LIGORE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE 16
2. KOMPETENCAT E KOMUNAVE 19
3. ORGANET E KOMUNËS 19
3.1. Këshilli 22
3.2. Kryetari i Komunës 23
3.3. Administrata komunale 25
4. AKTET E KOMUNAVE DHE PËRGATITJA DHE MIRATIMI I TYRE 25
4.1. Procedura për miratim 26
4.2. Përmbledhja e akteve të publikuara 26
4.3 Kontrolli i ligjshmërisë së akteve para publikimit të tyre 27
5. PROKURORIMET PUBLIKE DHE PARTNERITETI PRIVATO-PUBLIK 27
5.1. Prokurorimet Publike 29
5.2. Partneriteti Publiko-Privat 31
6. PRONËSIA KOMUNALE 31
6.1. Pronësia komunale dhe përvetësimi me pronësi komunale 31
6.2. Disponimi me pronësinë e komunës 33
6.3. Regjistri i pronës komunale 34
6.4. Mbrojtja e pronës 34
6.5. Menaxhimi me pronën 34
6.6. Si përvetësohet prona 34
6.7. Përgjegjësia për keqpërdorimin e pronës komunale 35

7. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBANISTIK 35
7.1. Plani hapësinor 35
7.2. Plane urbanistike 36
7.3. Procedura për përpunimin dhe miratimin e planeve urbanistike 37
7.4. Dokumentacioni planifikues urbanistik 37
7.5. Dokumentacioni urbanistiko-projektues (akte të tjera brenda planifikimit urbanistik) 38
8. TOKA NDËRTIMORE DHE MIRATIMI I LEJES PËR NDËRTIM 38
8.1. Toka ndërtimore 40
8.2 Lëshimi i lejes për ndërtim 40
8.2.1. Ndërtime të kategorisë së dytë 40
8.2.2. Autoritetet kompetente për lëshimin e lejeve për ndërtim për ndërtime të kategorisë së dytë 41
8.2.3. Procedura për lëshimin e lejeve të ndërtimit 42
8.2.4. Mbikëqyrja inspektuese 43
9. SHËRBIMET KOMUNALE 45
10. NDËRMARRJET PUBLIKE DHE INSTITUCIONET PUBLIKE 45
10.1. Ndërmarrjet publike 46
10.2. Institucionet publike 48
11. FINANCAT PUBLIKE TË VETËQEVERISJES LOKALE 48
11.1. Procesi buxhetor 48
11.2. Përmbajtja e buxhetit 50
11.3. Burimet e financimit të komunave 51
11.4. Paqëndrueshmëria financiare e komunave 52
12. TRANSPARENCA FISKALE 52
12.1. Transparenca buxhetore 53
12.2. Dokumente buxhetore dhe buxhetimi me pjesëmarrje 56
KORNIZA LIGJORE 56

Lista e shkurtesave

ESHS – Enti Shtetëror i Statitikës
ShQV – Shoqatë për Qëllime të Veçanta
BE – Bashkimi Evropian
SEPP – Sistemi Elektronik për Prokurorimin Publik
IITSI – Instituti për Inxhinierinë e Tërmeteve dhe Sizmologjinë Inxhinierike
IPA – Instrumenti i Ndihmës së Para-Aderimit
KV – Kilovat
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
MV – Mikrovat
NNjTS – Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika
OBI – Indeksi i Buxhetit të Hapur
OPSE – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Partneritet
PTT – Posta-Telefoni-Telegrafi
RM – Republika e Maqedonisë
GLN – Gazi i Lëngshëm i Naftës

CIP - Katalogimi në botim
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën. Kliment Ohridski ", Shkup

352(497.7)(035)TRAJANOVSKI, Mirosllav
Doracak për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë / Mirosllav Trajanovski, Marjan Nikollov Ana Maria Petrovska. - Shkup : Qendra për analiza ekonomike -CEA, 2018. - 74 faqe. : ilustr. ; 30 cm
Shënimet e tekstit

ISBN 978-608-4731-43-61.

Nikollov, Marjan [autor] 2. Petrovska, Ana Marija [autor]a) Vetëqeverisjes locale - Maqedoni - Doracakët

COBISS.MK-ID 105952778

Të nderuar Kryetarë Komunash dhe Këshilltarë,

Para jush gjendet një vegël, gjegjësisht Doracak që mund të ju shërbejë për tu gjindur më lehtë në materien ligjore, e cila e rregullon fushën për të cilën ju jeni zgjedhur nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Ky Doracak nuk është një enciklopedi e plotë e të gjitha kompetencave, aktiviteteve dhe procedurave. Madje, as që ka një ambicie të tillë. Ky Doracak është i organizuar ashtu që të jep një pasqyrë të përgjithshme të legjislacionit për tu gjindur më lehtë udhëzime në lidhje me legjislacionin që është zbatuar më së shpeshti dhe materiale në rast se ka nevojë për më shumë informacione. Gjithashtu, Doracaku në fjalë përqëndrohet në disa tema që janë më pak të hulumtuara nga ana e doracakëve të ngjashëm, por që janë të rëndësishme për ekzekutimin më efektiv të detyrimeve tuaja. Ky Doracak është i organizuar në 12 kapituj dhe çdonjëri prej tyre mund të përdoret si një njësi e veçantë me shpresë se kjo do të ju ndihmojë që të kryeni me sukses funksionin tuaj, i cili ka për qëllim një jetë më cilësore të qytetarëve dhe komunave tuaja.

Me respekt,
Marjan Nikollov
Kryetar i CEA-së

Të nderuar Kryetarë Komunash dhe Këshilltarë,

Në periudhën që vijon, pushteti qendror në bashkëpunim me pushtetin lokale do të punojnë në drejtim të përmirësimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale dhe procesit të decentralizimit të pushtetit. Përvoja juaj në kryerjen e funksioneve do të jetë shumë e rëndësishme në këtë proces të përcaktimit të prioriteteve dhe krijimit të politikave adekuate për zhvillimin lokal ekonomik, social dhe demokratik. Në këtë proces jemi të përfshirë të gjithë: autoritetet qendrore dhe lokale, sektori civil dhe sektori i biznesit si dhe, në kontekstin më të gjerë, të gjithë qytetarët. Puna jonë është e përbashkët sepse politikat e qeverisë në fushën e vetëqeverisjes lokale zbatohen nëpër komuna dhe përfituesit e përfitimeve janë qytetarët.

Kryetari i komunës dhe Këshilli janë dy organe të komunës të cilët janë përgjegjës për kryerjen e detyrave, secili brenda kompetencave të veta, por që të dy janë njësoj përgjegjës për funksionimin e komunës dhe sigurimin e shërbimeve për qytetarët.Ju përballeni me përgjegjësi të mëdha që dalin nga funksionet e komunës, por edhe nga pritjet e qytetarëve. Vetëqeverisja lokale është një çështje komplekse që rregullohet nga Kushtetuta dhe nga një numër i madh i ligjeve nga shumë fusha të ndryshme. Prandaj, çdo mbështetje në fillim të mandatit është e dobishme në zbatimin e përgjegjësive tuaja.Informimi është një kusht i rëndësishëm për kryerjen e funksionit në mënyrë të ligjëshme dhe në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë. Kjo nënkupton punë të përgjegjëshme, të ndreshme dhe transparente duke përfshirë edhe qytetarët në vendimmarrje.

Motoja jonë është: "Ministria e hapur për komunat dhe komunat e hapura për qytetarët". Në arritjen e këtyre qëllimeve, ju uroj punë të suksesshme në mandatin tuaj, funksionalitet të përmirësuar të komunave dhe rritje të kënaqësisë së qytetarëve për sa u përket shërbimeve të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Me respekt,
Ministëri për Vetëqeverisje Lokale
Suheil Fazliu

1. KORNIZA LIGORE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Nga njohuritë Tuaja për ligjet dhe aktet nënligjore[1] në lidhje me pushtetin lokal do të varet se sa do të jeni aktiv dhe efektiv në kryerjen e detyrave që i parparijnë mandatit Tuaj. Prandaj, së pari, është e nevojshme të njiheni me faktin se vetëqeverisjes lokale në vendin tonë i është dhënë një vend i veçantë në Kushtetutë dhe ligje. Kjo për Ju nënkupton edhe një përgjegjësi shtesë për të kryer me sukses detyrimet që qëndrojnë para Jush, dhe asisoj të justifikoni besimin që Ju kanë dhënë qytetarët.

Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale

Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale u miratua nga Këshilli i Evropës në vitin 1985. Republika e Maqedonisë këtë Kartë e nënshkroi në vitin 1996 dhe e ratifikoi në vitin 1997. Sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, pushteti lokal është një formë e qeverisjes në komunitetet lokale në të cilat qytetarët, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve që ata zgjedhin, vendosin për interesat dhe çështjet me rëndësi lokale. Sipas Kartës, autoritetet lokale, respektivisht organet komunale nuk paraqesin format e vetme të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke qenë se qytetarët munden që drejtpërdrejt të vendosin për çështjet me rëndësi lokale përmes formave të ndryshme të pjesëmarrjes siç janë: tubimi i qytetarëve, iniciativat qytetare, referendumet dhe format tjera. Përmes kësaj të drejte, gjegjësisht përmes së drejtës për vendimmarrje të dretpërdrejt, qytetarëve u jepet mundësia që në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë të marrin pjesë në vendimmarrje që kanë të bëjnë me interesat e tyre të përditshme dhe që posedojnë rëndësi lokale. Rregullorja ligjore e Maqedonisë, e cila ka të bëjë me vetëqeverisjen lokale, është në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

Në lidhje me çështjen e përcaktimit të kompetencave të vetëqeverisjes lokale, Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale ndërtohet mbi disa parime:

1. Sipas Kartës, të drejtat themelore dhe detyrat e pushtetit lokal përcaktohen me kushtetutë dhe me ligj. Kjo nënkupton që shteti, i cili është nënshkrues i Kartës në kushtetutën e vet dhe në ligjet që i miraton, duhet të parashikojë të drejtat dhe detyrat e autoriteteve lokale. Ose, më konkretisht, kjo do të thotë se me kushtetutë ose në ligj duhet të thuhet qartë se cilat janë organet përmes të cilave ekzekutohet pushteti lokal dhe se cilat janë të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve.
2. Sipas Kartës, autoritetet lokale, brenda kornizës së ligjit, kanë liri veprimi për të kryer vepra që nuk janë të përjashtuara nga kompetencat e tyre dhe nuk janë nën kompetencat e një autoriteti tjetër. Ky parim për përcaktimin e kompetencave të autoriteteve lokale është parashikuar me qëllim që autoritetet lokale të jenë në gjendje të kryejnë punë me interes publik dhe vlerë lokale nëse në territorin e asaj njësie ka punë të tilla.
3. Sipas Kartës për përcaktimin e kompetencës, punët publike duhet të kryhen kryesisht nga ato autoritete që janë më afër qytetarëve.
4. Funksionet që u janë besuar autoriteteve lokale në parim janë të plota dhe ekskluzive. Kjo do të thotë se ata funksione nuk duhet të merren apo kufizohen nga një autoritet tjetër, qoftë qendror apo rajonal, përveç në raste të parashikuara me ligj. Me fjalë të tjera, kompetenca e pushtetit lokal për të krijuar

1) Në këtë doracak jepet edhe një listë e nënligjeve të caktuara të miratuara nga ana e pushtetit qendror, të cilët dalin nga ligjet që ndërlidhen me kryerjen e kompetencave të komunës. Për aktet tjera nënligjore jepen udhëzime përmes faqeve të internetit që shpien deri tek to.

shërbime publike për kryerjen e çështjeve brenda kompetencave të tij duhet të jetë e plotë, në mënyrë që autoritetet lokale do të vendosin poqëse do të krijojnë shërbim publik dhe cilat do të jenë aktivitetet që do të kryhen prej tij. Gjithashtu, autoritetet lokale do të kontrollojnë punën e shërbimit në fjalë, do të miratojnë plane si dhe llogari vjetore.

5. Autoritetet lokale munden që ushtrimin e përgjegjësive apo kompetencave që u janë bartuar atyre nga qeveria qendrore ta përshtasin me kushtet lokale. Megjithatë, gjatë atij procesi ata duhet t'u përmbahen disa standardeve të caktuara.
6. Kur planifikohen dhe miratohen vendime të caktuara nga autoritetet qendrore, të cilat u referohen autoriteteve lokale, ata konsultohen në kohë dhe në mënyrë adekuate.

Sipas Kartës, kufijtë e territorit brenda të cilëve shtrihet kompetenca e autoriteteve lokale nuk guxojnë të ndryshohen pa u konsultuar paraprakisht me komunitetet lokale të cilave ata u referohen. Prandaj, nëse ekziston mundësia, ky konsultim duhet të bëhet përmes një referendumi të parashikuar me ligj.

Për të kryer me sukses përgjegjësitë apo kompetencat sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, autoritetet lokale kanë të drejtë të themelojnë organe të veta të menaxhimit, në të cilët do të punojë staf profesional. Do të thotë, autoritetet lokale do të organizojnë administratë të veten. Strukturën e brendshme do ta përcaktojnë vet në përputhje me nevojat e tyre. Në administratë do të punësohet staf profesional sipas nevojave dhe kompetencave që kanë ato autoritete lokale, si dhe në përputhje me kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës. Për të arritur një shkallë të lartë të profesionalizmit dhe kompetencës, punonjësve do tu krijohen kushte dhe mundësi për trajnim, shpërblim adekuat dhe mundësi për avancim në karrierë.

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale përcakton kushte të caktuara për punën e funkcionarëve lokal. Kushtet e punës së funkcionarëve të përzgjedhur lokal duhet të jenë të atilla që t'u mundësojnë atyre të kryejnë lirshëm funksionet që u përkasin. Këto kushte nënkuptojnë kompensim adekuat financiar për shpenzimet e bëra përgjatë kryerjes së këtyre funksioneve. Të gjitha ata funksione dhe aktivitete, që konsiderohen si të kryqëzuara me kryerjen e detyrës së një funkcionari lokal, përcaktohen me ligj ose me parimet themelore ligjore.

Për sa i përket çështjes së mbikëqyrjes administrative të punës së autoriteteve lokale, Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale urdhëron që të gjitha llojet e mbikëqyrjes administrative të mund të kryhen ekskluzivisht në raste të caktuara dhe duke ndjekur procedurë të përcaktuar me kushtetutë ose me ligj. Mbikëqyrja administrative i referohet përputhshmërisë së punës së autoriteteve lokale me kushtetutë dhe ligj.

Sa i përket financimit të autoriteteve lokale, në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale theksohet se autoritetet lokale, në përputhje me politikën ekonomike të vendit, kanë të drejtë për të shfrytëzuar disa burime të caktuara të vetë-financimit me të cilët disponojnë lirisht brenda pushetit të tyre. Karta parashikon që të paktën një pjesë e fondeve të autoriteteve lokale të rrjedh nga taksat lokale dhe tatimet tjera, vlerat e të cilave, brenda kufijve të ligjit, kanë të drejtë t'i përcaktojnë autoritetet lokale.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të interesave të përbashkëta të autoriteteve lokale, Karta parashikon se çdo shtet duhet të njohë të drejtën për të qenë anëtar i shoqatave të autoriteteve lokale, si dhe mundësinë për të qenë anëtar i organizatave ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

Duke pasur parasysh faktin që autoritetet lokale kanë kompetencat e tyre origjinale, zbatimin e të cilave ata e rregullojnë vet, brenda standardeve të përcaktuara, në Kartë theksohet se autoritetet lokale kanë të drejtë për mjete juridike për të siguruar ushtrimin e lirë të funksioneve të tyre dhe respektimin e parimeve të vetëqeverisjes lokale të garantuara me kushtetutë dhe ligj. Kjo do të thotë që autoritetet lokale kanë të drejtë që para gjykatave kompetente të kërkojnë të drejtën e mbrojtjes në rast se pengohet ushtrimi i kompetencave të tyre me akte dhe aktivitete të caktuara të organeve të autoriteteve shtetërore.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë qytetarëve u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale. Kushtetuta tregon se vetëqeverisja lokale do të rregullohet me një ligj të miratuar me shumicë votash prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në ndërkohë, është e patjetërsueshme që të sigurohet shumica e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Vetëqeverisja lokale në Kushtetutë është shtjelluar në një kapitull të veçantë (Kapitulli V, nenet prej 114 deri 117).

Me këtë rast, vetëm sa për të rikujtuar, në po këtë kapitull janë përcaktuar të drejtat e qytetarëve për të vendosur mbi çështje me rëndësi lokale në fushat e urbanizmit, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit ekonomik lokal, aktiviteteve komunale, kulturës, sportit dhe rekreacionit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, shëndetit dhe mbrojtjes nga zjarri. Gjithashtu, Kushtetuta garanton të ashtuquajturën kompetencë e deleguar, respektivisht mundësinë që organet shtetërore t'u transferojnë komunave kryerjen e disa detyrave të caktuara (neni 115, paragrafi 3). Në vendin tonë, Kushtetuta parashikon vetëqeverisje lokale prej një niveli të vetëm, që do të thotë se njësitë e vetëqeverisjes lokale janë komunat. Qytetit të Shkupit, si kryeqytet i vendit, i është dhënë një status i veçantë me atë që ky qytet është paraparë si një njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Kuptohet se për të kryer kompetencat që u janë dhënë, komunave u nevojiten burime financiare. Kështu, komunave me Kushtetutë u garantohet e drejta për t'u financuar nga burimet e veta të të ardhurave si dhe nga mjetet financiare të Republikës.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale

Në mënyrë që komunat të organizohen si komunitete lokale në të cilat qytetarët do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të vendosur mbi çështjet me rëndësi lokale, është e nevojshme që kjo çështje të shtjellohet veçmas me ligj. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, i cili për nga natyra është ligj sistematik/ organik dhe është miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, si dhe shumicën e votave të deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, e rregullon çështjen e kompetencave të komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje (iniciativën qytetare, tubimin e qytetarëve, referendumin), organizimin dhe punën e organeve komunale (këshillit dhe kryetarit të komunës), adminstratën komunale (organizimin dhe punën që ajo duhet të kryjë), aktet e miratuara nga këshilli dhe kryetari i komunës, pronën e komunës, mbikëqyrjen e punës së organeve të komunës (mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë dhe kontrollin dhe auditimin e punës materialo-financiare), shpërbërjen e Këshillit të komunës, mekanizmat e bashkëpunimit në mes të autoriteteve komunale dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë, pushtetit vendor (kompetencat, themelimin dhe organizimin), mbrojtjen e vetëqeversijes lokale, definimin e gjuhëve zyrtare në komunë, si dhe çështjet tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale rregullohet edhe çështja e vendbanimit sipas mënyrës që vijon: qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët kanë vendbanim të përhershëm në territorin e komunës, janë banorë të komunës. Çështja e vendbanimit është një çështje e rëndësishme për ushtrimin e disa të drejtave me rëndësi lokale të qytetarëve. Përkatësisht, vetëm banorë të komunës mund të zgjedhen për të kryer funksione në pushtetin lokal. Gjithashtu, banorët e komunës kanë të drejtë, nëpërmjet formave të vendimmarrjes direkte, të bëjnë sugjerime dhe iniciativa për zgjidhjen e çështjeve të caktuara me karakter lokal. Vendbanimi është gjithashtu i rëndësishëm për arye se vetëm banorët e komunës kanë mundësi të ushtrojnë disa të drejta dhe të përmbushin obligime të caktuara në komunë.

Ligji për Organizimin Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë

Me këtë ligj rregullohet: organizimi territorial i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë; themelimi i komunave si njësi të vetëqeverisjes lokale; përcaktimi i territoreve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale; përcaktimi i emrave, vend-qëndrimeve dhe kufijve të komunave; përcaktimi i llojit dhe emrave të vendbanimeve; ndarja dhe ndryshimi i kufijve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, si dhe çështje tjera që lidhen me organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale.

Sipas këtij ligji, në Republikën e Maqedonisë janë themeluar 84 komuna2 dhe Qyteti i Shkupit, i cili është njësi e posaçme e vetëqeverisjes lokale. Territori i Qytetit të Shkupit përbëhet nga zonat e komunave të qytetit të Shkupit. Kufijtë e komunave janë kufijtë kadastrale të komunave të vendbanimeve që janë pjesë përbërëse e komunës në pjesën që kufizohet me komunat fqinje. Gjegjësisht, kufiri për dy vendbanime që i përkasin dy komunave të ndryshme, por që kufizohen me njëri-tjetrin, do të vendoset sipas kufirit kadastral të komunve të vendbanimeve. Këtu duhet të dihet se kufijtë e komunave kadastrale nuk lejohet që të priten. Gjithashtu, nëse një komunë ndodhet në një zonë afër kufirit të Republikës së Maqedonisë me një vend tjetër fqinjë, kufiri i asaj komune do të përputhet me kufirin shtetëror. Meqenëse kemi thënë se komunat janë themeluar për një apo më shumë vendbanime, është e nevojshme të dihet se çfarë lloje të vendbanive ekzistojnë. Vendbanimet mund të jenë qytete dhe fshatra.

Qyteti, sipas kuptimit të dhënë në Ligjin për Organizim Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë, është një vendbanim me më shumë se 3000 banorë. I njejti ka të zhvilluar strukturën e veprimtarive dhe ka mbi 51% të të punësuarve jashtë industrive primare. Kjo do të thotë se në atë vendbanim duhet të ketë më shumë lloje të veprimtarive (industri, tregti, hotelieri, etj). Nga ana tjetër, mbi 51% e të punësuarve duhet të jetë e punësuar në veprimatritë që vetëm sa u përmenden. Ky vendbanim duhet të ketë të ndërtuar fizionomi urbane me zona të ndërtesave për banim, tregti, rekreacion dhe gjelbërim publik, shesh, sistem të ndërtuar të rrugëve, shërbime komunale dhe duhet të paraqesë një qendër funksionale të vendbanimeve në atë hapsirë. Kjo do të thotë se vendbanimi duhet të ketë miratuar plane urbanistike që përcaktojnë fizionominë e tij urbane, përcaktojnë zonat për të jetuar dhe punuar, si dhe definojnë sipërfaqet e destinuara për gjelbërim dhe rekreacion. Gjithashtu, në përputhje me planet urbanistike, vendbanimi duhet të ketë të ndërtuar rrugët dhe sheshin. Për të kryer shërbimet publike (furnizimin me ujë të pijshëm, kullimin e ujërave të zeza dhe të shiut, mirëmbajtjen e zonave të trafikut publik, marrjen e plehrave, etj), vendbanimi duhet të ketë të themeluar një ndërmarrje publike. Në të kundërtën, duhet që së paku kryerjen e këtyre aktiviteteve ta negocojë me persona fizik ose juridik duke nënshkruar kontratë për partneritet publiko-privat. Fshati, në kuptimin që i jepet në po të njëjtin ligj, është një vendbanim me kuptim njëfunksional, në të cilin mbizotëron vetëm një veprimtari. Gjithashtu, pamja e jashtme ka fizionomi dhe funksion agrar.

Vendbanimet i kanë kufijtë e tyre, të cilët janë të ndryshëm nga kufijtë kadastral të komunave në të cilat ata përkasin. Kështu, kufijtë e qytetit, si një vendbanim, përcaktohen me miratimin e planit të përgjithshëm urbanistik, ndërsa kufijtë e fshatit, si vendbanim, përcaktohen duke miratuar planin urbanistik për vendbanim. Përcaktimi i kufijve të vendbanimeve është një gjë shumë e rëndësishme sepse përmes tij përcaktohet një hapësirë e caktuar në të cilën mund të kryhen kompetenca të caktuara. Me miratimin e planeve urbane me të cilët përcaktohen kufijtë, toka që ndodhet brenda këtyre kufijve është tokë ndërtimore dhe si e tillë i nënshtrohet një mënyreje të veçantë të përdorimit. Gjegjësisht, brenda kornizave të planeve të definuara, në këtë tokë mund të bëhet ndërtim i ndërtesave, sigurisht, pasi të kenë siguruar leje ndërtimi. Gjithashtu, komuna është përgjegjëse për rregullimin e tokës ndërtimore. Ekzekutimi i aktiviteteve komunale është brenda kufijve të përcaktuar nga planet apo diçka tjetër të ngjashme. Çdo qytet e ka emrin e vet. Emrat e vendbanimeve përcaktohen me ligj. Sipas rregullit, në territorin e një komune, nuk mundet që dy ose më shumë vendbanime të kenë emrin e njejtë.

Ligji për Qytetin e Shkupit

Ky ligj rregullon: organizimin e Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale; kompetencat dhe financimin e qytetit dhe komunave të Shkupit; përdorimin e gjuhëve të komuniteteve në qytetin e Shkupit dhe në komunat e Shkupit; bashkëpunimin mes Qytetit të Shkupit dhe komunave të Shkupit; si dhe çështje tjera me rëndësi për qytetin e Shkpit. Ligji i rradhit dhe i përkufizon punët me interes publik dhe rëndësi lokale që janë nën kompetencat e qytetit të Shkupit, si dhe ato që janë nën kompetencat e komunave në qytet të Shkupit. Komunat në Shkup, në kuadër të ligjit dhe në përputhje me parimin e sub-

2) Që nga viti 2008 janë 80 komuna pasi që nga dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të Ligjit për Organizimin Territorial të Vetëqeverisjes Lokale të botuar në vitin 2004, me Nenin 16 ishte e paraparë që komunat Zajas, Oslomej, Vranesticë dhe Drugovo të funksionojnë si të pavarura deri në vitin 2008, kur ata u bënë pjesë përbërëse e komunës së Kërçovës.

sidiaritetit, kanë të drejtë që në territorin e komunës të kryejnë punë me interes publik dhe rëndësi për komunën. Punë këto që nuk përjashtohen nga kompetencat e tyre, nuk janë nën kompetencën e organeve të pushtetit shtetëror apo nën kompetencën e Qytetit të Shkupit. Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, për të kryer punët publike me rëndësi lokale që bien nën kompetencat tyre, mund të themelojnë shërbime publike (ndërmarrje publike dhe institucione publike), në pajtim me ligjin. Dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale vlejnë edhe për komunat në Qytetin e Shkupit edhe për Qytetin e Shkupit, përveç nëse me këtë ligj parashikohet ndryshe.

Ligji mbi Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale

Komunat dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit e financojnë ekzekutimin e kompetencave të tyre nga burimet e tyre të të ardhurave dhe burimet tjera të financimit. Komunat janë të pavarura për sa u përket burimeve financiare që kanë në dispozicion. Pavarësia reflektohet në atë se komuna përcakton shumën e taksave vendore, taksat komunale, kompensimet etj. Njëashtu, nga fondet e mbledhura planifikohen edhe shpenzimet për ekzekutimin e programeve që ndërmerren nga komuna. Burimet vetanake të të ardhurave janë tatimet lokale, taksat komunale lokale dhe kompensimet, si dhe burimet tjera të financimit të përcaktuara me Ligjin për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale. Gjithashtu, me këtë ligj rregullohen çështjet buxhetore, kontabiliteti, huamarrja, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me financimin e komunave.

Ligji për Bashkëpunimin Ndër-Komunal

Sipas këtij ligji, bashkëpunimi ndër-komunal paraqet bashkëpunim që vendoset në mes dy ose më shumë komunave me qëllim që të bëjë kryerjen më efikase të kompetencave të komunave, të cilat janë të përcaktuara me ligj, si dhe të mundësojë ushtrimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta. Me bashkëpunim ndër-komunal nënkuptohet edhe kryerja e detyrave të caktuara që bien nën kompetencën e një komune nga ana e një komunë tjetër, edhe atë në llogari të një ose më shumë komunave tjera në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të komunave. Ligji parashikon shumë forma të bashkëpunimit ndër-komunal. Kështu, bashkëpunimi ndër-komunal mund të arrihet përmes:

a) krijimit të trupave për bashkëpunim ndër-komunal:
   - trup të përbashkët punues dhe komision; dhe
   - trup të përbashkët administrativ; dhe

b) krijimit të shërbimeve të përbashkëta publike
   - ndërmarrje të përbashkët publike; dhe
   - institucion të përbashkët publik.

Bashkëpunimi ndër-komunal mund të arrihet përmes nënshkrimit të kontratave për:
   - grumbullimin e mjeteve financiare, materiale dhe të tjera; dhe
   - kryerjen e punëve të caktuara nga ana e një komune për një ose më shumë komuna tjera.

Një formë tjetër e bashkëpunimit ndër-komunal është formimi i trupave të përbashkëta punuese dhe komisioneve për shqyrtimin e çështjeve të caktuara nën kompetencën e kryetarit të komunës ose këshillit komunal.

Për më tepër, bashkëpunimi ndër-komunal mund të realizohet nëpërmjet krijimit të një trupi të përbashkët administrativ, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Ligj ky, i cili do të bëj ekzekutimin e kompetencave të caktuara të komunave të definuara me ligj. Kryerja e punëve të caktuara nga ana e një komune

për një ose më shumë komuna tjera përmes nënshkrimit të një marrëveshje gjithashtu paraqet një formë të bashkëpunimit ndër-komunal. Bashkëpunimi ndër-komunal mund të arrihet duke bashkuar mjetet financiare, materiale apo mjetet tjera, ashtu si që është paraparë në marrëveshjen e nënshkruar.

Ligji për Zhvillimin e Barabartë Rajonal

Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal si dhe për zbatimin e masave dhe instrumenteve për të inkurajuar zhvillimin e barabartë rajonal krijohen rajone planifikuese dhe përcaktohen zona me nevoja specifike zhvillimore.

Rajonet planifikuese janë njësi të NNjTS (Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikë) të nivelit të tretë të definuar me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për të përcaktuar Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikë (NNjTS). Nga ana tjetër, zonat me nevoja specifike zhvillimore janë:

- zonat kufitare, rurale, kodrinore dhe zonat tjera që mbeten prapa në zhvillim,
- zonat me burime natyrore dhe trashëgimi kulturore të mbrojtura me ligj, dhe
- zonat tjera me nevoja specifike zhvillimore të përcaktuara me ligj.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton listën e zonave me nevoja të veçanta zhvillimore, me propozim të Këshillit për zhvillim të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë.

Planifikimi i zhvillimit rajonal bëhet me dokumente planifikuese për zbatimin e të cilave miratohen edhe plane akcionare, edhe atë me:

- Strategjinë e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Maqedonisë, dhe
- Programin për Zhvillimin e Rajonit Planifikues.

Bartës të politikave për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal janë:

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
- Këshilli për Zhvillim të Barabartë Rajonal të Republikës së Maqedonisë,
- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, dhe
- Këshilli për Zhvillimin e Rajonit Planifikues.

Byroja për Zhvillim Rajonal dhe Qendrat për Zhvillimin e Rajonit Planifikues marrin pjesë në planifikimin e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e dokumenteve planifikuese për zhvillimin rajonal. Burimet për financimin e zhvillimit rajonal janë:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë,
- buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale,
- fondet e Bashkimit Evropian,
- burimet tjera ndërkombëtare,
- donacionet dhe sponsorizimet nga individë dhe persona juridikë, dhe
- mjetet tjera të përcaktuara me ligj.

Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale

Subjekt i këtij ligji është zhvillimi i mëtejshëm i dispozitave të Ligjit pët Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilave mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e rregulloreve komunale zbatohet nga Ministria për Vetëqeverisje Lokale. Gjegjë-

sisht, përveç kontrollit të rregulloreve para publikimit të tyre, gjë që e bën kryetari i komunës në bazë të Ligjit për Vetëqeversije Lokale, ligji në fjalë rregullon mbikëqyrjen e ligjshmërisë së rregulloreve të komunave, si dhe mbikëqyrjen mbi procedurën për miratimin e tyre, gjë që bëhet nga Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale, si organ brenda Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale. Mbikëqyrja e inspektimit mund të jetë:

1) mbikëqyrje e rregullt e inspektimit;

2) mbikëqyrje e jashtëzakonshme e inspektimit dhe

3) mbikëqyrje kontrolluese e inspektimit.

Gjatë kryersjes së inspektimit, nëse inspektori vlerëson se ka bazë për pezullimin e një rregulloreje të miratuar nga këshilli komunal për shkak të mos-përputhjes me Kushtetutën ose ligjin, atëherë ai përgatit vendim për ndalimin e zbatimit të rregullores. Gjithashtu, inspektori përgatit iniciativë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregullores para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë. Vendimi për të ndaluar zbatimin e rregullave të caktuara, dhe iniciativa për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë merret nga drejtori i Inspektoratit dhe të njëjtat publikohen brenda tri ditëve në faqen e internetit të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale. Kundër vendimit për të ndaluar zbatimin e rregulloreve të caktuara mund të bëhet ankim te Ministri i Vetëqeverisjes Lokale, gjë që nuk do të vonojë ekzekutimin e vendimit. Për marrjen e vendimit për të ndaluar zbatimin e rregullores, botimin e tij dhe ndërmarrjen e iniciativës për të nisur procedurën për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, zbatohen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kodi Zgjedhor

Sipas këtij ligji, anëtarët e këshillit të komunës, antarët e këshillave të komunave në qytetin e Shkupit dhe antarët e këshillit të Qytetit të Shkupit, si dhe kryetari i komunës, zgjedhen nga qytetarët e komunës në zgjedhjet e përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit, është pranuar modeli proporcional, përderisa për zgjedhjen e kryetarit të komunës është pranuar modeli i shumicës. Në sistemin proporcional, mandatet e antarëve të këshillit fitohen në mënyrë proporcionale karrshi votave për listat zgjedhore, përderisa te modeli i shumicës në raundin e parë fiton kandidati që ka marrë më shumë vota nga votuesit e dalë në votim, me kusht që të ketë fituar të paktën 1/3 e votuesve të regjistruar. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë, në raundin e dytë shkojnë vetëm dy kandidatët me numrin më të madh të votave të fituara. Në fund fiton ai kandidat që ka fituar më shumë vota nga votuesit që kanë dal në votim.

2. KOMPETENCAT E KOMUNAVE

Këtu do të njoftohemi shkurtimisht me kompetencat e komunave të rradhitura në nenin 22 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Sipas listës së kompetencave, komunat janë përgjegjëse për çështje që përkasin në fushat e mëposhtme:

Planifikimi urban (urban dhe rural), lëshimi i lejeve për ndërtimin e objekteve me rëndësi lokale, rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore

Përcaktimi i llojit të planeve, procedura e miratimit të tyre, vendimi për kushtet e lokacionit, si dhe disa çështje tjera të planifikimit që janë në kompetencë të komunës, përcaktohen me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Urbanistik. Përcaktimi i objekteve me karakter lokal, si dhe lëshimi i lejes për ndërtim, mbikëqyrja dhe punë të tjera që ndërlidhen me ndërtimin për të cilin komuna është përgjegjëse, rregullohet me Ligjin për Ndërtim. Meqenëse ndërtimi bëhet në tokë që sipas planeve është paraparë për ndërtim, rregullimi i asaj toke, si dhe rregullimi i hapsirës, si kompetencë e komunës, përcaktohet me Ligjin për Tokën Ndërtimore.

Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës

Ky term nënkupton ndërmarrjen e masave për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, si dhe mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimi jo-jonizues.

Zhvillimi ekonomik lokal

Ky term nënkupton planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal, vendosjen e prioriteteve zhvillimore dhe strukturore, udhëheqjen e politikës ekonomike lokale, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrjeve në nivel lokal, themelimin dhe zhvillimin e rrjetit të institucioneve dhe agjencive lokale, si dhe promovimin e partneritetit. Cilat do të jenë kompetencat e komunës në këtë fushë dhe çfarë masash do të mund të ndërmerr ajo (kryesisht këtu u referohet planifikimit dhe prioriteteve në planet strategjike, mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, rrjetit të institucioneve dhe agjencive që do të zhvillohen), do të varet nga kompetenca e cila është transmetuar nga ligjet e zonës përkatëse, të tillë si Ligji për Tregti, Ligji për Veprimtari Hotelierike, Ligji për Turizmin, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe ligjet tjera të kësaj fushe.

Veprimtaritë Komunale

Veprimtaritë komunale nënkuptojnë: sigurimin e qytetarëve me ujë të pijshëm përmes ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ujësjellësit, furnizimin me ujë teknologjik, kullimin dhe pastrimin e ujërave të zeza dhe ujrave atmosferike përmes ndërtimit të kanalizimit sanitar dhe atmosferik, si dhe impianteve për trajtimin e ujit, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e higjienës publike, transportimin dhe trajtimin e mbeturinave të ngurta dhe teknologjike të komunës, rregullimin dhe organizimin e transportit lokal të pasagjerëve, furnizimin me gaz natyror dhe energji ngrohëse, mirëmbajtjen e varrezave, krematoriumeve dhe ofrimin e shërbimeve të varrimit, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve lokale, si dhe rrugëve dhe objektet tjera infrastrukturore, rregullimin e regjimit të trafikut, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit rrugor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të parkimit publik, heqjen e automjete të parkuara në mënyrë të paligjshme, heqjen e automjeteve të dëmtuara nga hapësirat publike, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve, pastrimin e oxhaqeve, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e parqeve, hapësirave të gjelbra, parqeve pyjore dhe sipërfaqeve rekreative, rregullimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e shtretërve të lumenjëve në pjesët e urbanizuara, përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore.

Kompetencat në fushën e veprimtarive komunale rregullohen kryesisht nga ligjet dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ato ligje. Megjithatë, ekzistojnë disa çështje të caktuara, të cilat komunat i rregullojnë me dispozitat apo rregullat e vetat, të tilla si, për shembull: rregullimi i punimeve lidhur me pastrimin e oxhaqeve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit të trafikut rrugor, rregullimi i regjimit të trafikut, ndriçimi publik, mirëmbajtja dhe përdorimi i parqeve, gjelbërimi, parqet pyjore dhe zonat rekreative.

Kultura

Kultura nënkupton mbështetjen institucionale dhe financiare të institucioneve dhe projekteve kulturore; kultivimin e folklorit, zakoneve, mjeshtrive të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimin e ngjarjeve kulturore; inkurajimin e krijimtarisë së shumëllojshme të formave të veçanta. Këtu, vend të veçantë ka Ligji për Kulturë, i cili përcakton se cila është kompetenca e komunës dhe gjatë përcaktimit të institucioneve të karakterit kombëtar, lë hapësirë për komunat të përcaktojnë cilat institucione janë të karakterit lokal. Sidoqoftë, Ligji për Muzetë, Ligji për Bibliotekat dhe ligjet tjera në këtë fushë nuk mund të delegojnë kompetenca mbi komunat.

Sporti dhe rekreacioni

Termi sport dhe rekreacion i referohet zhvillimit të sporteve masive dhe aktiviteteve rekreative; organizimit të ngjarjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtjes dhe ndërtimit të objekteve sportive dhe mbështetjes së shoqatave sportive. Çfarë aktivitetesh dhe deri në çfarë mase komunat do të kryejnë ato aktivitete në këtë fushë përcaktohet me Ligjin për Sport.

Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve

Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve nënkupton financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kopshteve të fëmijëve dhe shtëpive për të moshuarit; realizimin e kujdesit social për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me probleme edukativo-sociale, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët nga familje me prind të vetëm, fëmijët e rrugës, personat e ekspozuar ndaj rrezikut social, personat e prekur nga abuzimi me drogën dhe alkoolin; pastaj, ngritjen e vetëdijes së popullatës; strehimin e personave me rrezik social; ushtrimin e së drejtës për edukim dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore. Vëllimi i kompetenca ve në këtë fushë mund të gjendet në Ligjin për Mbrojtjen Sociale, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në ligjet tjera në këtë fushë.

Arsimi

Arsimi nënkupton themelimin, financimin dhe administrimin e shkollave fillore dhe të mesme në bashkëpunim me qeverinë qendrore dhe në përputhje me ligjin, si dhe organizimin e transportit dhe ushqyerjes së nxënësve dhe vendosjen e tyre në konvikte. Mënyra e themelimit, financimit, administrimit (zgjedhja e organeve shkollore) zgjidhet me Ligjin për Arsimin Fillor dhe Ligjin për Arsimin e Mesëm.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor nënkupton menaxhimin e rrjetit të organizatave të shëndetit publik dhe objekteve të kujdesit shëndetësor parësor të cilat duhet të përfshijnë përfaqësimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha bordet e të gjitha organizatave shëndetësore në pronësi publike, arsimin shëndetësor; përmirësimin e shëndetit; aktivitetet parandaluese; mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtjen gjatë orarit të punës; mbikëqyrjen shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse; ndihmën për pacientët me nevoja të veçanta. Në këtë fushë, kompetenca e komunës është përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Sëmundjet Infektive dhe Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit.

Mbrojtja nga zjarri

Mbrojtja nga zjarri është një mbrojtje që kryhet nga njësitë territoriale të zjarrfikësve. Cilat njësi zjarrfikëse janë nën kompetencat e komunës, si funksionojnë ata, si plotësohen, si pajisen dhe prej ku financohen etj. është e rregulluar me Ligjin për Zjarrfikësit.

Mbikëqyrja mbi kryerjen e veprimtarive nën kompetencën e saj

Komunat e kanë këtë kompetencë me qëllim që të jenë në gjendje të mbikëqyrin punën e shërbimeve publike që ata kanë themeluar. Mbikëqyrja kryhet nëpërmjet miratimit të programeve të punës dhe të planeve financiare të shërbimeve publike që ka krijuar komuna, si dhe nëpërmjet miratimit të raporteve operacionale (të punës) dhe llogarive vjetore të të njejtëve.

Mënyra dhe kushtet për kryerjen e kompetencave të numëruara

Kompetencat e numëruara kryhen në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara me ligje të veçanta, përmes të cilëve, gjithashtu, komunat autroizohen që me rregullore komunale të rregullojnë apo përmirësojnë mënyrën dhe kushtet për kryerjen e kompetencave të caktuara. Gjithashtu, këto ligje përcaktojnë funksionet nën kompetencë të komunës që komuna domosdoshmërisht duhet të kryej. Gjegjësisht, në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale është dhënë vetëm lista e kompetencave në fusha të caktuara, përderisa cilat punë dhe deri në çfarë mase, sipas cilave standarde dhe sipas cilave procedura do të kryhen ata nga ana e komunave, përcaktohet me ligje të posaçme materiale që rregullojnë mënyrën dhe kushtet për kryerjen e aktiviteteve të caktuara. Kështu, për shembull, komunat janë përgjegjëse për miratimin e planeve hapësinore dhe urbanistike, për rregullimin e tokës ndërtimore dhe dhënien e lejeve për ndërtimin e objekteve që janë me rëndësi lokale. Ky formulim në ligj është shumë i përgjithshëm dhe specifikimi i tij do të bëhet me ligje të posaçme, akte nënligjore dhe akte të komunës. Në rastin konkret, me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Urbanistik përcaktohet se cilët plane miratohen nga komuna, përmes cilës procedure, kush i zbaton, dhe çështje të tjera. Ligji për Ndërtim përcakton procedurën për lëshimin e lejes së ndërtimit, përcakton objektet që janë me rëndësi lokale dhe atë se kush bën mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Punë tjera të përcaktuara me ligj

Përveç kompetencave të lartpërmendura, komunat mund të kryejnë edhe kompetenca tjera të përcaktuara me ligje tjera që rregullojnë mënyrën dhe kushtet për kryerjen e aktiviteteve të caktuara.

Kompetencë e deleguar

Nëqoftëse vlerësohet se zbatimi i disa aktiviteteve brenda kompetencave të një organi të caktuar të administratës shtetërore do të jetë më efikas sikur të bëhet nga ana e komunës, atëherë ai organ shtetëror mund t'ia delegojë atë detyrë komunës. Mënyra e zbatimit mund të përshtatet me kushtet lokale, duke marrë parasysh standardet e përcaktuara me ligj. Kur ekziston një situatë e tillë, fondet për zbatimin e detyrave të tilla sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Organi i administratës shtetërore gjithashtu do të jetë përgjegjës për moskryerjen apo për kryerjen e vonuar të detyrave.

Mënyra e kryerjes së kompetencave

Komunat, në mënyrë që të kryejnë kompetencat e tyre, në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mund të themelojnë shërbime publike në pajtim me ligjin. Kështu, në fushën e shërbimeve komunale ato krijojnë ndërmarrje publike, përderisa në fushën e kulturës krijojnë institucione kulturore me karakter lokal: biblioteka, muze etj., krijojnë institucione publike. Kryerjen e disa punëve të caktuara me interes publik e me rëndësi lokale, komuna mund të delegojë edhe tek persona tjerë juridik apo persona fizik, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për të kryer aktivitete të interesit publik, në pajtim me ligjin. Kështu, me marrëveshje të nënshkruar, mirëmbajtjen e higjienës publike ose grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të ngurta dhe industriale të komunës prej një vendbanimi apo prej një pjese të një vendbanimi, komuna mund t'ia delegojë një personi juridik apo një personi fizik përmes nënshkrimit të marrëveshjes për lidhjen e një partneriteti publiko-privat. Në të dy rastet, komuna është përgjegjëse për kryerjen e çështjeve me interes publik.

3. ORGANET E KOMUNËS

Në bazë të nenit 31 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, organet e komunës janë: këshilli dhe kryetari i komunës

3.1. Këshilli

Këshilli është trup përfaqësues i qytetarëve. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit rregullohet me ligj. Mandati i anëtarëve të këshillit është 4 vjet.

Mënyra e punës së këshillit

Këshilli vendos brenda kompetencave të komunës.

Për çështje që janë të një fushe të caktuar, këshilli prej përbërjes së tij mund të krijojë komisione të përhershme dhe të përkohshme. Cilët komisione do të formohen dhe sa do të jetë numri i anëtarëve të tyre është rregulluar me statutin e komunës. Zakonisht, komisionet formohen për një fushë të caktuar ose më shumë fusha të ngjashme, dhe gjatë procesit të zgjedhjes së antarëve kujdes i veçantë i kushtohet asaj se sa ata antarë e njohin atë fushë. Meqë këshilli është i përbërë nga këshilltarë që u përkasin partive të ndryshme politike, gjatë krijimit të komisioneve duhet të ruhet përfaqësimi proporcional i të gjitha partive politike që kanë anëtarë në këshill. Nëqoftëse më shumë se 20% e qytetarëve të komunës janë anëtarë të një komuniteti të caktuar, atëherë krijohet një komision për marrëdhënie në mes të komuniteteve, që ka për qëllim shqyrtimin e çështjes së marrëdhënieve ndër-etnike, marrëdhënieve ndërmjet komunitetit më të madh dhe komunitetit që i përkasin 20% ose më pak 20% e qytetarëve. Ky komision është i rëndësishëm sidomos kur vendoset mbi çështje dhe rregulla që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës dhe alfabetit, si dhe emblemën dhe flamurin e komunës.

Kompetencat e këshillit

Këshilli komunal në veçanti kryen këto kompetenca: - miraton statutin e komunës dhe rregulloret tjera; - kujdeset për performancën financiare të komunës, për çka e miraton buxhetin komunal dhe llogaritë vjetore, e përcakton tavanin e burimeve të veta të të ardhurave dhe kryen kontroll financiar të buxhetit komunal, krijon agjencitë publike për të kryer kompetencat e komunës, mbikëqyr punën e tyre dhe emëron anëtarët në bordet e menaxhimit të shërbimit publik; - vendos për mënyrën e sigurimit të pronësisë së komunës; - emëron menaxherin e nën-njësisë së Ministrisë së Brendshme në komunë në përputhje me ligjin, dhe monitoron sigurinë publike në komunë; - vendosë për dhënien e lejes për kryerjen e aktiviteteve me interes publik me rëndësi lokale, respektivisht merr vendim për fillimin e procedurës për dhënien e kontratës për krijimin e një partneriteti publiko-privat; dhe kryen aktivitete tjera të përcaktuara me nenin 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me ligje tjera.

Konstituimi i këshillit

Seanca parë e këshillit pas përfundimit të zgjedhjeve thirret nga kryetari i këshillit nga përbërja e mëparshme jo më vonë se 20 ditë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Nëqoftëse kryetari i përbërjes së mëparshme nuk e thërret këshillin brenda këtij afati kohor, atëherë anëtarët e këshillit takohen vet dhe, nën kryesimin e anëtarit më të vjetër të këshillit, e konstituojnë këshillin brenda 10 ditëve pas mbarimit të periudhës prej 20 ditësh.

Duhet të kushtohet kujdes që të mos lëshohet ky afat, sepse në rast të atillë do të duhet të shpallen zgjedhje të reja. Numri i anëtarëve të këshillit, varësisht nga numri i banorëve të komunës, është i ndryshëm dhe lëvizë nga 9 deri në 33 anëtarë. Këshilli i Qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, përbëhet nga 45 këshilltarë.

Zgjedhja e kryetarit të këshillit

Kryetari i këshillit zgjedhet nga rradha e anëtarëve të këshillit, me mandat katërvjeçar. Kandidati që ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit zgjedhet kryetar i këshillit. Nëse në raundin e parë asnjë nga kandidatët për kryetar nuk merr numrin e kërkuar të votave, atëherë mbahet një raund i dytë votimi për dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave në raundin e parë. Për kryetar të këshillit zgjedhet ai antar i këshillit, i cili ka marrë më shumë vota në raundin e dytë të votimit.

Deri në zgjedhjen e kryetarit, këshilli mblidhet dhe drejtohet nga anëtari më i vjetër i këshillit.

Të drejtat dhe obligimet e kryetarit të këshillit

Kryetari i këshillit:

1. I thirr dhe i udhëheq seancat e këshillit;

2. Kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit; dhe

3. I nënshkruan rregulloret e miratuara nga këshilli dhe brenda tri ditëve nga dita e miratimit të tyre i dorëzon te kryetari i komunës për publikim.

Seancat e këshillit

Për punën e këshillit është e nevojshme shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Këshilli punon përmes seancave dhe i njejti thirret nga kryetari i këshillit. Kryetari i këshillit thërret seancë edhe me kërkesë të kryetarit të komunës ose me kërkesë të së paku 1/4 së anëtarëve të këshillit. Nëse është paraqitur kërkesë për thirrje të një senace nga kryetari i komunës ose anëtarët e këshillit, kryetari i këshillit e thërret seancën jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës. Nëqoftëse kryetari nuk e thërret seancën brenda afatit të caktuar, atëherë anëtarët e këshillit të njejtën e thërrasin vetë dhe për atë seancë ata zgjedhin një kryetar. Vendimi për thirrjen e seancës, së bashku me rendin e propozuar të ditës, duhet të dorëzohet jo më vonë se 7 ditë para ditës së caktuar për seancën. Kjo kohë është e nevojshme për të shqyrtuar materialet e propozuara me rendin e ditës, për të mbledhur informacion shtesë mbi këto materiale, të cilat mund të merret nga administrata komunale ose burime tjera, për tu konsultuar me njerëz të cilët janë ekspertë në atë fushë me qëllim që të merret pjesë aktive në debatin mbi këto materiale në vetë seancën dhe të merren vendime që janë në interes të qytetarëve.

Mund të ndodhin situata të caktuara që nuk mund të planifikohen ose të parashikohen me program. Nëse krijohet një situatë e tillë, atëherë këshilli mund të mbajë një seancë të jashtëzakonshme. Në statutin e komunës duhet të theksohet se në cilat raste mund të mblidhet një seancë e jashtëzakonshme. Seanca e jashtëzakonshme mblidhet nga kryetari i këshillit me iniciativën e tij ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të këshillit. Njoftimi për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme përcakton vendin dhe kohën për mbajtjen e saj, si dhe rendin e ditës për atë seancë. Ndryshe nga seancat e rregullta, në të cilat është e mundur të propozohen ndryshime dhe shtesa në rendin e ditës, rendi i ditës nuk mund të ndryshohet në seancat e jashtëzakonshme. Në seancë, para fillimit të punës, është e detyrueshme të votohet për arsyetimin e dhënë për thirrjen e asaj seance. Në mënyrë që këshilli të punojë, është e nevojshme që në seancë të merr pjesë shumica e anëtarëve të numrit të përgjithshëm të antarëve të këshillit. Vendimet e marra nga këshilli miratohen me votim, i cili, sipas rregullës, është publik.

Këshilli vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm (një shumicë relative), përveç nëse parashihet ndryshe me ligj dhe me statut.

Megjithatë, në statutin e komunës mund të parashikohet se për miratimin e disa rregulloreve nevojitet një shumicë ndryshe e votave. Këshilli komunal, në kuadër të kompetencave të tij, miraton rregullore, të cilat, veç tjerash, i referohen kulturës, përdorimit të alfabeteve dhe gjuhëve që flasin më pak se 20% e qytetarëve

të komunës dhe vendos për përdorimin e emblemës dhe flamurit të komunës. Këto rregullore do të miratohen nëse të njejtat votohen nga shumica e pjesëmarrësve, me ç'rast është e patjetërsueshme të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të këshillit që i përkasin komunitetit që nuk është shumicë në komunë.

Seancat e këshillit janë publike. Kjo u jep qytetarëve mundësinë për t'u informuar për punën dhe vendimet që merren dhe që, sigurisht, janë në funksion të mundësimit të realizimit të së drejtës së vetëqeverisjes lokale për qytetarët. Megjithatë, ekzistojnë situata ose çështje që diskutohen nga këshilli, në të cilat publiku mund të përjashtohet nga përcjellja e seancave. Për të mos abuzuar me këtë të drejtë, është e nevojshme që në statutin e komunës të parashikohen këto çështje dhe të jepen arsye të justifikuara. Përkundër parashikimit të këtyre çështjeve në statut, gjithmonë është e nevojshme që këshilli të merrë një vendim për të përjashtuar publikun. Vendim ky, i cili miratohet me dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Megjithatë, publiku nuk mund të përjashtohet nëse këshilli diskuton buxhetin komunal, llogarinë vjetore të buxhetit dhe planet urbanistike.

Konflikt i interesave

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale rregullon çështjen e konfliktit të interesave të anëtarëve të këshillit, duke parashikuar që një anëtar i këshillit nuk mund të vendosë për çështjet në të cilat ai, bashkëshorti/ja i/e tij, fëmija i tij ose ndonjë familjarë i brezit të dytë ka një interes personal ose financiar, për të cilën ai është i detyruar ta informojë këshillin.

Përfundimi i mandatit të një anëtari të këshillit

Nëse ndodhin situata të caktuara, mandati i anëtarit të këshillit mund të ndërpritet edhe para mbarimit të 4 viteve. Kështu, mandati i anëtarit të këshillit ndërpritet nëse:

- Këshilltari vetë jep dorëheqje;
- Ka ndërruar jetë;
- Këshilltari është dënuar me aktgjykim për vepër kriminele me burg për më shumë se gjashtë muaj;
- Në rast të papajtueshmërisë së funksionit të anëtarit të këshillit, në përputhje me Kodin Zgjedhor;
- Këshilltarit i merret aftësia për punë me vendim me fuqi juridike;
- Këshilltari pushon të jetë banor i asaj komune.

Nëse ndodh ndonjë nga rastet e lartëpërmendura, këshilli do të konstatojë arsyen dhe ditën e përfundimit të mandatit të anëtarit të këshillit në seancën e ardhshme.

Anëtari i këshillit mund të privohet nga mandati i tij nëse mungon pa arsye të justifikueshme tre herë me rradhë në seancat e këshillit. Për justifikimin e mungesës, këshilli vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Shpërbërja e këshillit

Këshilli i themeluar mund të shpërbëhet në rast se shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit e shqipton atë. Këshilli gjithashtu shpërndahet nëse:

- do të miratojë përsëri rregulloren që paraprakisht Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë ka anuluar ose shfuqizuar me vendim;
- merr një vendim që rrezikon sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Maqedonisë;
- nuk takohet, respektivisht mban një seancë për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj; dhe
- nuk e miraton buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit deri më 31 mars të atij viti.

Në rast se paraqitet ndonjë nga rastet e lartëpërmendura, përkatësisht nëse vjen deri tek shpërbërja e këshillit, atëherë puna e këshillit kryhet nga kryetari i komunës deri në zgjedhjen e një këshilli të ri. Megjithatë, kryetari i komunës, në kryerjen e veprimtarive nën kompetencë të këshillit, nuk do të mund të vendosë për çështje që kanë të bëjnë me:

- disponimin e pronës komunale, që do të thotë se nuk mund të marrë vendime për shitjen e pronës së komunës
- blerje ose shitje;
- miratimin e rregulloreve për të cilat është kompetent këshilli
- vendimmarrjen nëse ai ose bashkëshortja e tij, fëmijët ose familjarët e brezit të dytë kanë interes financiar ose interes tjetër personal.

3.2. Kryetari i Komunës

Funksioni i kryetarit të komunës është profesional.

Duke pasur parasysh kompetencat, dhe duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një individ, është e pashmangshme nevoja për të specifikuar një person që do ta zëvendëson atë. Në rast se kryetari i komunës pengohet nga ushtrimi i funksionit të tij, ai mund të zëvendësohet nga një anëtar i këshillit. Procedura e përcaktimit të një personi, i cili do të zëvendësojë kryetarin e komunës, përcaktohet me anë të statutit të komunës. Anëtari i këshillit, i cili zëvendëson kryetarin, pushon të jetë anëtar i këshillit dhe nuk mund të marrë pjesë në punën e këshillit. Kryetari i këshillit nuk mund të zëvendësojë kryetarin.

Kompetenca e kryetarit të komunës

Kryetari i komunës prezanton dhe përfaqëson komunën dhe kryen, në veçanti, punët e mëposhtme: - kontrollon ligjshmërinë e rregulloreve të këshillit dhe i boton ato në gazetën zyrtare të komunës; - siguron ekzekutimin e vendimeve të këshillit dhe punët që me ligj i delegohen komunës; - propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit komunal dhe ekzekuton buxhetin e komunës; - zgjedh drejtorët e shërbimeve publike të themeluara nga komuna në bazë të konkurrencës publike; - menaxhon administratën komunale, miraton rregullat për sistematizimin e administratës komunale dhe vendos për punësimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj; - siguron përdorimin e duhur dhe të ligjshëm të pronës së komunës, si dhe mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e së njejtës; - vendos për çështjet administrative, për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë, në përputhje me ligjin; dhe kryen aktivitete tjera të përcaktuara me nenin 50 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me ndonjë ligj tjetër, si dhe me statutin e komunës.

Kryetari i komunës mund të autorizojë një zyrtar komunal që të udhëheq procedurën dhe të vendosë në çështjet administrative, si dhe të nënshkruajë akte individuale.

Konflikt i interesave

Kryetari i komunës nuk mund të emërohet si anëtar i organeve mbikëqyrëse, administrative dhe organeve të kontrollit të shoqatave tregtare dhe shërbimeve publike. Kryetari i komunës nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje në të cilat ai ose bashkëshortja e tij, fëmijët ose familjarët e brezit të tij të dytë kanë interes financiar ose interes tjetër personal, për çka ai është i detyruar ta informojë këshillin.

Përfundimi i mandatit

Edhe pse kryetari i komunës zgjedhet për një mandat prej 4 vitesh, mandati i tij mund të përfundojë edhe më herët. Përkatësisht, mandati i kryetarit të komunës mund të përfundojë nëse:

- tai vetë jep dorëheqje nga funksioni i kryetarit të komunës;
- kryetari ndërron jetë;
- kryetari është dënuar me akt-akuzë për vepër penale me burgim për më shumë se gjashtë muaj;
- me vendim ligjor i merret e drejta e punës;
- në rast të papajtueshmërisë së funksionit të kryetarit të komunës, në përputhje me Kodin Zgjedhor;
- mungon për më shumë se 6 muaj dhe këshilli, me shumicën e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vjen në përfundimin se mungesa është e pajustifikuar;
- pushon së qeni banor i komunës.

Në rast të ndërprerjes së mandatit të kryetarit të komunës, anëtari i këshillit, i cili e zëvendëson kryetarin e komunës, në bazë të nenit 54, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është i obliguar që të informojë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, e cila më pas e informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Pasi konstatohet se ka ndodhur një nga rastet, Qeveria në të njëjtën kohë fillon procedurë për shpalljen e zgjedhjeve për kryetar të komunës. Nga ana tjetër, si kryetar deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, në përputhje me nenin 54, paragrafi 5 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, zgjedhet një nga anëtarët e këshillit, i cili do të kryejë detyrat e kryetarit për periudhën deri sa të zgjedhet kryetari i ri, sipas mënyrës së njejtë që zgjedhet kryetari i këshillit.

3.3. Administrata komunale

Administrata komunale organizohet për kryerjen e detyrave në kompetencë të këshillit dhe kryetarit të komunës, duke kryer punë profesionale dhe administrative. Administrata komunale kryen veçanërisht detyrat e mëposhtme: - përgatit aktet për këshillin dhe kryetarin e komunës, për seancat e këshillit, si dhe seancat e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme – e udhëheqë kontabilitetin e komunës; - e monitoron problematikën që është nën kompetencat e komunës , analizon situatën dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre; merret me dokumentet e komunës dhe i mban ata deri në shkatërrimin e tyre, domethënë dorëzimin e tyre në Arkivat Shtetërore të Republikës së Maqedonisë; dhe kryen punë të tjera që përcaktohen dhe kërkohen nga këshilli dhe kryetari i komunës.

Organizimi

Organizimi, fushëveprimi dhe mënyra e kryerjes së detyrave të administratës komunale përcaktohet nga këshilli, në bazë të propozimit të kryetarit të komunës.

Administrata komunale është e organizuar në sektore dhe sekcione. Në përcaktimin e sektorëve, gjithnjë duhet të merret parasysh madhësia e komunës, zhvillimi i saj, vëllimi i kompetencave të saj, megjithatë, në çdo rast, numri i sektorëve nuk mund të jetë më i vogël se dy. Sekcionet organizohen brenda sektorëve dhe numri i tyre nuk mund të jetë më pak se dy sekcione.

Statusi i të punësuarve në komunë

Punonjësit e administratës komunale që kryejnë çështje profesionale, rregullatore, ligjore, ekzekutive, administrative dhe mbikëqyrëse dhe vendosin për çështjet administrative kanë statusin e nëpunësit civil. Me marrjen e statusit të nëpunësit civil, për punonjësit e administratës komunale zbatohen dispozitat e Ligjit për Nëpunës Civil në fushën e punësimit, të drejtave dhe detyrimeve, të sistemit të pagave dhe kompensimeve, përgjegjësisë, vlerësimit dhe ndërprerjes së punësimit.

Numri i të punësuarve, kushtet që ata duhet të përmbushin, titujt e tyre, në pajtim me Rregulloren mbi titujt dhe përshtatshmërinë e vendeve të punës me grupet dhe titujt/pozicionet e përcaktuar me Ligjin për

Nëpunësit Civil ("Gazeta Zyrtare" No.93 / 2000), Vendimin për përcaktimin e përshtatshmërisë së vendeve ekzistuese të punës në komuna me grupet dhe titujt/pozicionet e përcaktuara nga ana e Ligjit për Nëpunës Civil dhe ligje tjera të veçanta, në të cilët janë të përcaktuara kushtet specifike për vende të caktuara të punës (inspektorë, auditorë të brendshëm, kontabilist përgjegjës etj.), si dhe përshkrimi dhe inventari i punëve dhe detyrat e punës që duhet të kryhen, përcaktohen me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale të miratuar nga kryetari i komunës.

Do të thotë, jo të gjithë punonjësit në administratën komunale kanë statusin e nëpunësit civil. Ata punonjës të administratës komunale që kryejnë punë administrativo-teknike ose ndihmëse nuk kanë statusin e nëpunësit civil dhe për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre vlejnë dispozitat e legjislacionit të punës .

Rregullimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive, si dhe rekrutimi dhe vlerësimi i nëpunësve civil është i rregulluar me ligj të veçantë, dhe ndarja e tyre nga pjesa tjetër e të punësuarve bëhet për shkak të detyrave të caktuara që ata kryejnë. Me këtë vendim, përmes afirmimit të parimeve të administrimit komunal profesional, apolitik, efikas dhe të përgjegjshëm, sigurohet kryerje cilësore dhe në kohë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Statusi i garantuar i nëpunësit civil i një kategorie të caktuar të të punësuarve në komuna dhe në Qytetin e Shkupit duhet të sigurojë administratë cilësore dhe kompetente lokale si një shërbim të vërtetë për qytetarët, të rekrutuar në baza meritokratike, e jo në bazë të përkatësisë politike dhe partiake.

Klasifikimi i nëpunësve civil

Nëpunësit civil klasifikohen në tri grupe:

- nëpunësit civil menaxherial;
- nëpunës civil profesional dhe
- nëpunës civil administrativo-profesional.

4. AKTET E KOMUNAVE DHE PËRGATITJA DHE MIRATIMI I TYRE

Organet e komunës, në ushtrimin e kompetencave të tyre, miratojnë akte të përgjithshme dhe individuale. Aktet e përgjithshme rregullojnë marrëdhëniet dhe të drejtat e detyrimet për qytetarët dhe personat tjerë juridikë, brenda kompetencave të komunës. Kryetari miraton akte individuale kur vendoset me procedurë administrative ose kur bëhen përzgjedhje ose emërime, si dhe në raste tjera të parashikuara me ligj ose rregullore tjera.

Përveç statutit, këshilli i komunës në kuadër të kompetencave të tij gjithashtu miraton aktet/ rregullore të përgjithshme, siç janë:

- nprogramet dhe planet;
- vendimet; dhe
- rregulloret tjera të përcaktuara me ligj.

Statuti i komunës, si akti më i lartë, rregullon: organizimin dhe funksionimin e organeve të komunës; organizimin dhe funksionimin e komisioneve të këshillit; kryerjen e punëve me interes publik me rëndësi lokale, të cilat nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e komunës dhe nuk janë në kompetencë të autoriteteve shtetërore; mënyrën e informimit të qytetarëve; rastet e përjashtimit të publikut nga seancat e këshillit; mënyrën dhe procedurën për dorëzimin e parashtresave dhe propozimeve për punën e organeve komunale dhe veprimin ndaj tyre; mënyrën e organizimit të tribunave publike, kryerjen e anketimeve dhe mbledhjen e propozimeve nga qytetarët; mënyrën e kryerjes së obligimeve në fushën e mbrojtjes në gjendje lufte; si dhe çështje tjera të rëndësishme për vetëqeverisjen lokale.

Programet dhe planet rregullojnë dhe përpunojnë çështje të caktuara për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera, me të cilët barten kompetencat e komunës, dhe për të cilat është e nevojshme të parashikohen afatet dhe dinamika e ekzekutimit (për shembull: programi i higjienës komunale, programi për furnizimi me ujë, etj.). Më konkretisht, me vendime rregullohet një çështje e caktuar brenda kompetencës së komunës (për shembull: vendim për themelimin e shërbimeve publike në kompetencë të komunës, vendim për miratimin e planeve urbanistike etj.)

4.1. Procedura për miratim

Procedura për miratimin e akteve të përgjithshme/ rregulloreve fillon me dorëzimin e propozimit për miratim, i cili mund të paraqitet nga: kryetari i komunës, anëtarët e këshillit, trupat punues të këshillit, si dhe 10% të votuesve në komunë. Propozimi përmban arsyet se pse duhet të sillet ai akt dhe përmbajtjen e aktit. Nëse me porpozimin për miratim dorëzohet edhe porpozim-akti, atëherë propozim-akti i përgjithshëm duhet të përfshijë bazë ligjore për miratimin e tij, burimet e nevojshme financiare për zbatimin e tij dhe mënyrën e sigurimit të atyre mjeteve financiare. Drafti i aktit/rregullores së përgjithshme shkon përmes diskutimeve në organet kompetente të këshillit dhe vendoset në rend të ditës në seancë të këshillit. Pas përfundimit të debatit mbi draftin, qëndrimet dhe vërejtjet me konkluzion i dorëzohen propozuesit me qëllim që ai t'i ketë parasysh gjatë përpunimit të propozim-aktit.

Rregulloret miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj ose me ligj tjetër.

Rregulloret publikohen te gazeta zyrtare e komunës më së voni brenda një periudhe prej shtatë ditëve nga dita e miratimit të tyre. Rregulloret hyjnë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit, përveç nëse parashihet ndryshe në statut.

4.2. Përmbledhja e akteve të publikuara

Administrata komunale mban një përmbledhje të akteve të botuara e të miratuara nga organet komunale. Në këtë përmbledhje, aktet regjistrohen sipas emërimit të tyre. Kjo do të thotë që programet dhe planet

regjistrohen në një pjesë, përderisa vendimet dhe llojet tjera të akteve që janë miratuar regjistrohen në një pjesë tjetër. Në përmbledhje ndohet tërë teksti i aktit me numrin dhe datën e miratimit të tij, si dhe numri i gazetës zyrtare të komunës në të cilën ai është botuar. Gjithashtu, regjistrohen edhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e bëra në akte. Qytetarët e interesuar munden në çdo kohë të inspektojnë përmbledhjen dhe të marrin të dhënat e nevojshme nga ajo.

4.3 Kontrolli i ligjshmërisë së akteve para publikimit të tyre

Nëse këshilli miraton një rregullore në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet, atëherë për të parandaluar hyrjen e saj në fuqi, kryetari i komunës, brenda 7 ditëve që nga dorëzimi nga ana e kryetarit të këshillit, duhet të miratojë një vendim për të ndaluar botimin e asaj rregulloreje në gazetën zyrtare. Vendimi duhet të jetë i shtjelluar, respektivisht duhet të jepen arsyet se pse rregullorja që nuk është botuar është në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjet. Gjegjësisht, në arsyetimin e vendimit duhet të jepen nenet e Kushtetutës apo ligjit me të cilat rregullorja e miratuar është në kundërshtim. Nëse ndodh kjo situatë, keshilli komunal është i detyruar të rishikojë vendimin dhe të vendosë mbi të brenda 15 ditëve që nga publikimi i vendimit. Dy zgjidhje janë të mundshme:

a) Këshilli të pranojë arsyet e theksuara në vendim dhe të mos e miratojë rregulloren ose, nëse ka mundësi, ta harmonizojë atë;

b) Këshilli nuk pranon arsyet e dhëna në vendim dhe e konfirmon rregulloren e miratuar më parë.

Nëse ndodh që këshilli të konfirmojë rregulloren, atëherë kryetari do ta publikojë atë te gazeta zyrtare. Me këtë, detyra e kryetarit të komunës nuk ka përfunduar. Tani ai duhet të iniciojë një iniciativë për të filluar një procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregullores së kontestuar deri tek Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë.

Këti ekziston edhe një detyrim tjetër për kryetarin e komunës, sipas së cilit kryetari i komunës duhet t'ia dorëzojë rregulloren Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të saj.[3]

3) Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e rregulloreve të komunës, që kryhet nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale përmes Inspektoratit Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale, shpjegohet më hollësisht në Ligjin për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale.

5. PROKURORIMET PUBLIKE DHE PARTNERITETI PRIVATO-PUBLIK

5.1. Prokurorimet Publike

Ligji aktual për Prokurimin Publik u miratua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në nëntor të vitit 2007 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 136/07). Duke qenë se fusha e prokurimit publik është shumë dinamike dhe subjekt i ndryshimeve në vetë Bashkimin Evropian, Republika e Maqedonisë duhet të harmonizojë në vazhdimësi legjislacionin kombëtar me ligjin e Bashkimit Evropian dhe në të njëjtën kohë të promovojë praktika të mira ndërkombëtare. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit aktual të Prokurimit Publik, i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar disa herë. Kështu, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, u prezantua çertifikimi i detyrueshëm i zyrtarëve për prokurimin publik me qëllim të ngritjes së profesionalizmit dhe përgjegjësisë së publikut. U prezantua obligimi për publikimin e detyrueshëm të shpalljeve dhe gjatë zbatimit të procedurës me kërkesë për të mbledhur oferta për dhënien e kontratave të prokurimit publik me një vlerë të parashikuar deri në 5,000 euro.

Në këtë mënyrë është hequr mundësia e sjelljes diskrecionale të autoriteteve kontraktuese, të cilët më së shpeshti gjatë kryerjes së procedurës së dhënë u janë drejtuar ofertuesve të caktuara që të njëjtit të paraqesin ofertat e tyre. Gjithashtu, është futur obligimi për të kryer një e-ankand, si një mënyrë për të lidhur kontratat për prokurorime publike (pavarësisht nga lloji i procedurave të ndërmarra dhe vlerës së kontratave të dhëna).

Me qëllim të mbrojtjes së autoriteteve kontraktuese, ofertuesit joserioze që pa arsye tërhiqen nga procedura për lidhjen e kontratave, si dhe nga ofertues të cilët nuk kanë kursyer gjatë zbatimit të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kontratat e prokurimit publik, u fut instrumenti i referencës negative.[4]

Me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit, u prezantua edhe një instrument tjetër i rëndësishëm i njohur si dialogu teknik. Dialogu teknik është një konsultim në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese në mes të autoriteteve kontraktuese me komunitetin e biznesit në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe në veçanti në lidhje me specifikimet teknike të lëndës së prokurimit. Përkatësisht, për autoritetet kontraktuese u fut detyrimi i domosdosshëm për të zbatuar dialog teknik gjatë kryerjes së procedurave për dhënien e kontratave të prokurimeve publike për mallra dhe shërbime me vlerë të llogaritur mbi 130,000 euro. Një detyrim i rëndësishëm që u imponua ndaj autoriteteve kontraktuese është sigurisht detyrimi për publikimin e detyrueshëm të dokumentacionit të tenderit në sistemin elektronik për prokurimin publik (SEPP). Në të njëjtën kohë, si një mënyrë e veçantë për dhënien e kontratave të prokurimit publik, te kontratat sektoriale (furnizimi me ujë, energji, transport, shërbime postare dhe aktivitete tjera të mbuluara) u fut sistemi klasifikues, gjë që rriti efikasitetin e tyre.

Përveç me anë të Ligjit për Prokurimin Publik, sistemi i prokurimit publik rregullohet edhe me anë të disa akteve nënligjore që rrjedhin prej tij. Këto mund të gjenden në botimet përkatëse të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", si dhe në faqen e internetit të Zyrës së Prokurimit Publik, www.bjn.gov.mk në seksionin e Rregulloreve. Gjatë dhënies së kontratave të prokurimit publik, autoritetet kontraktuese janë të detyruara të respektojnë parimet bazë, përkatësisht të sigurojnë:

- konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomikë,
- trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë,
- transparencë dhe integritet në procesin e dhënies së kontratave të prokurimeve publike, dhe
- përdorimi racional dhe efikas të fondeve në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.

4) Ankandi i detyrueshëm elektronik, si dhe çmimi më i ulët si kriteri i vetëm për vlerësimin e ofertave, duke përfshirë edhe instrumentin e referencës negative, bazuar në rekomandimin e fundit të Bashkimit Evropian, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit që do të pasojnë, sipas të gjitha gjasave do të hiqen nga Ligji për Prokurimin Publik. Është paralajmëruar edhe heqja e Këshillit të Prokurimit Publik.

Ekzistojnë tri lloje të kontratave të prokurimit publik:

- kontrata për prokurorim publik të mallrave,
- kontrata për prokurorim publik të shërbimeve, dhe
- kontrata për prokurimin publik të punëve.

Duke pasur parasysh se blerjet përfaqësojnë një formë të furnizimit për autoritetet kontraktuese me mallra, shërbime ose punë, të njejtët duhet të planifikojnë blerjet e tyre në vitin aktual. Përveç kësaj, autoriteti kontraktues në pajtim me nenin 26 të ligjit, në bazë të burimeve të përcaktuara të financimit, miraton një plan për totalin e nevojave të tij vjetore të prokurimit për vitin aktual sipas llojeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit, me të cilin e përcakton fillimin e parashikuar të procedurës, vlerën e parashikuar të kontratës dhe llojin e procedurës për dhënien e kontratës. Ky plan duhet të jetë në kuadër dhe i barabartë me fondet e siguruara për prokurim, të cilat janë brenda kufijve të buxhetit, respektivisht planet financiare ose programet e investimeve. Autoriteti kontraktues e miraton planin e prokurimit publik deri në fund të janarit të vitit aktual.Sipas nevojës, autoriteti kontraktues mund të ndryshojë ose plotësojë planin vjetor të prokurimit gjatë vitit në përputhje me fondet e planifikuara dhe të siguruara të prokurimit publik. Sa u përket kontratave shumëvjeçare (procedurë për këto kontrata zbatohet në një vit të caktuar, përderisa zbatimi i tyre mund të zgjasë disa vjet), në planin vjetor të prokurimit publik futen edhe kontratat që do të zbatohen gjatë disa viteve, edhe atë në planin e vitit kur është planifikuar zbatimi i procedurës për dhënien e kontratës së prokurimit publik. Autoriteti kontraktues këto kontrata nuk duhet ti parashikojë në planet për vitet e ardhshme, për shkak se vitin e ardhshëm ata do të jenë në fazë të realizimit, derisa procedura ka përfunduar më herët. Procedurës me negocime pa publikimin e ankandit nuk futen në planin e prokurimit, pasiqë të njejtat nuk është e mundur të parashikohen në kohën e që ato miratohen. Zbatimi i procedurës së negociuar në përputhje me arsyet e deklaruara duhet të futet në kolonën Vërejtje nga Formulari i Planit të Prokurimit Publik. Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet se plani vjetor i prokurimit publik duhet të përfshijë prokurimin deri në 5,000 euro në kundërvlerë në denarë. Vetëm blerjet deri në 500 euro nuk përfshihen në plan. Para fillimit të procedurës për dhënien e një kontrate shumëvjeçare, autoriteti kontraktues është i detyruar të planifikojë fondet e nevojshme për zbatimin e tij me anë të buxhetit, programin e investimeve dhe planin financiar për atë vit. Gjegjësisht, autoriteti kontraktues mund nënshkruaj kontratë që do të zgjasë për një periudhë më të gjatë, respektivisht më shumë se një vit dhe, në ndërkohë, për pjesën e kontratës që mbulon vitin e ardhshëm, autoriteti kontraktues duhet të ketë parashikuar fonde në buxhetin, respektivisht planin financiar për vitin përkatës.

Autoriteti kontraktues vendos për nevojën për prokurim publik, duke miratuar një vendim në përputhje me nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit. Gjegjësisht, bazuar në planin e miratuar vjetor të prokurimit, personi përgjegjës i autoritetit kontraktues (Kryetari i komunës) ose personi i autorizuar prej tij do të vendosë për prokurimin publik, në përputhje me të cilën inicohet ngritja e procedurës për dhënien e kontratës për prokurorim publike, me qëllim që të përmbushë nevojat. Procedura e prokurimit publik kryhet nga një komision i prokurimit publik i formuar nga kryetari i komunës, përkatësisht personi i autorizuar prej tij, përbërja e të cilit përcaktohet me vendim për prokurim publik. Në punën e komisionit për prokurime publike mund të marrin pjesë ekspertë të jashtëm pa të drejtë për të vendosur. Brenda komunës duhet të përcaktohet një person, respektivisht disa persona ose një formë organizative (departament, sektori apo të ngjashme), në kuadër të së cilit do të kryhet puna në fushën e prokurimit publik.

Ligji për Prokurimin Publik i parasheh procedurat e mëposhtme të cilat autoritetet kontraktuese mund ti përdorin për kontratat për prokurorim publik, edhe atë: - Procedurë e hapur është një procedurë në të cilën çdo operator ekonomik mund të dorëzojnë tenderin. - Procedurë e kufizuar është një procedurë në të cilën çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje dhe vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktues ftohen për tenderim. - Dialogu Konkurruese është një procedurë në të cilën çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje dhe autoriteti kontraktues kryen një dialog me kandidatët e përzgjedhur, në mënyrë që të përcaktojë një ose më shumë zgjidhje të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e tij dhe në bazë të të cilave kandidatët e përzgjedhur do të përgatisin ofertën e tyre.

- Procedurë e negociuar me publikim dhe pa publikim të një thirrjeje për oferta. – Procedura me kërkese për mbedhjen e ofertave është procedurë më e thjeshtë për dhënien e një kontrate të prokurorimit publik, i cili kryhet kur duhet të shpërndahen kontrata vlera e të cilave është deri në 5.000 euro me kundërvlerë të shprehur në denarë ose 20.000 euro me kundërvlerë të shprehur në denarë për mallra dhe shërbime, respektivisht deri në 50,000 euro me kundërvlerë të shprehur në denar për punë.

5.2. Partneriteti Publiko-Privat

Qëllimi i partneritetit publiko-privat është për të lejuar angazhimin e subjekteve private për financimin, ndërtimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve publike apo vetëm për ofrimin e shërbimeve publike, të cilat në një farë mënyrë paraqesin të drejtë ekskluzive të sektorit publik, në këtë rast të pushtetit lokal. Si partner publik mund të paraqiten komunat dhe ndërmarrjet publike, si dhe institucionet publike dhe shoqatat tregtare të themeluara nga ana e komunave.

Modelet bazë të partneriteteve publike-private janë:

1. "Koncesion për punë publike", i cili është definuar si një kontratë e llojit të njëjtë si kontrata për prokurorim publik, përveç se kompensimi për ato punë ngërthehet në të drejtën e përdorimit të atyre punëve, ose në këtë të drejtë së bashku me pagesën;

2. "Koncesion për shërbimi publik", i cili është definuar si një kontratë e llojit të njëjtë si kontrata për prokurorim publik të shërbimeve përveç se komepnsimi për këto shërbime ngërthehet në të drejtën e përdorimit të këtyre shërbimeve ose në këtë të drejtë së bashku me pagesën; dhe

3. "Forma të tjera të partneritetit publiko-privat" si një kontrate e prokurorimit publik për punë ose kontratë prokurorim publik për shërbim.

Sipas Ligjit, partneriteti publiko-privat nënkupton një formë të bashkëpunimit afatgjatë të kontraktuar ndërmjet partnerit publik dhe partnerit privat, i cili karakterizohet me vetit e mëposhtme:

a) partneri privat merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike për përdoruesit e fundit në fushat e kompetencës së partnerit publik dhe/ ose detyrimin për t'i ofruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve publike për përdoruesit e fundit dhe/ ose aktivitete nën kompetencën e tij;

b) në mënyrë që të përmbushë detyrimet, partneri privat mund të marrë përsipër detyrën: - për të financuar, projektuar, ndërtuar dhe/ ose rindërtuar/rinovuar objekt të infrastrukturës publike, për punuar dhe për të ruajtur objektin e ri dhe/ ose rindërtuar/rinovuar objekt të infrastrukturës publike ose – për të përdorur, menaxhuar dhe mirëmbajtur një strukturë ekzistuese të infrastrukturës publike, ose - çfarëdo kombinim i detyrimeve të sipërpërmendura përderisa kombinimi i këtyre detyrimeve synon përmbushjen e objektivave të përcaktuara;

c) Kur të marrë përgjegjësi, partneri privat zakonisht merr përsipër rreziqe të konsiderueshme që lidhen me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ ose disponueshmërinë dhe aktivitete të tilla të tjera, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe rreziqet teknike, në varësi të marrëveshjes dhe vendoset nga rasti në rasti;

d) secili partner në partneritet privato-publik për kohëzgjatjen e partneritetit privato-publik do të marrë përgjegjësinë për ngjarjet e rrezikut që janë në sferën e tij të ndikimit, ose përgjegjësia ndahet për të arritur menaxhimin optimal të rrezikut për kohëzgjatjen e partneritetit, ndër të tjera, me përdorimin e aftësive menaxheriale, teknike, financiare dhe inovative të partnerit privat dhe duke promovuar shkëmbimin e shkathtësive dhe njohurive në mes të partnerit publik dhe partnerit privat;

e) në këmbim të detyrimeve të ndërmarra, partneri publik mund t'i japë partnerit privat një koncesion për një punë publike ose koncesion për një shërbim publik, ose ta rimbursojë atë me pagesë;

f) partneri publik, gjithashtu, mund të lejojë partnerin private për të kryer aktivitete të caktuara komerciale ekonomike, të përcaktuara në kontratë, por vetëm në qoftë se nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të siguruar nivelin e nevojshëm të efikasitetit të çmimit të pjesëmarrjes private dhe një kthim të arsyeshëm të investimit; dhe

g) partneri publik mund t'i transferojë disa të drejta partnerit privat që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të kontraktuara.

Partneriteti publiko-privat mund të realizohet në bazë të një kontrate, ose me themelimin e një shoqate të përzier midis partnerit publik dhe partnerit privat (partneritet publiko-privat institucional). Për realizimin e partneritetit kontraktual publiko-privat, zakonisht partneri privat krijon një shoqatë me qëllim të veçantë (DPN).

Gjatë procedurës së dhënies së kontratës për partneritet publiko-privat në mënyrë adekuate zbatohet Ligji për Prokurorim Publik. Përfitimi që pritet nga lidhja e marrëveshjes për themelimin e një partneriteti publiko-privat është:

- Përfshirja e sektorit privat në ndërtimin dhe financimin e infrastrukturës publike dhe/ ose sigurimi i shërbimeve publike që normalisht dhe tradicionalisht i siguron sektori publik, me çka tejkalohet hendeku i nevojës për të siguruar një shërbim publik dhe mungesa e fondeve në buxhetet e qeverive lokale për këtë qëllim.
- Shërbime publike më cilësore për paratë e investuara dhe mundësi më të mëdha për përdoruesit e shërbimeve publike; arritja e një "vlere për para" më të mirë
- Zbatimi më i shpejtë i projektit dhe reduktimi i shpenzimeve të projektit, si dhe kostot e ciklit jetësor të projektit;
- Menaxhimi më i mirë dhe qasja në menaxhimin e specializuar;
- Krijimi i të ardhurave shtesë për partnerin publik, përmes pagesës së kompensimit të koncesionit, etj;
- Përmirësimin e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik.

Në nivel lokal, mund të realizohen më tepër projekte të partneritetit privato-publik për ofrimin e shërbimeve publike me interes lokal, edhe atë në disa fusha, si:

- Aktivitetetet komunale (ndriçimi publik, grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i mbeturinave komunale, rregullimi dhe organizimi i transportit publik të udhëtarëve lokal, furnizimi me ngrohje, organizimi dhe ofrimi i shërbimeve të parkimit etj.);
- Aktivitetet arsimore (ndërtimin e ndërtesave shkollore);
- Sporti (ndërtimi i sallave sportive dhe stadiumeve);
- Kultura (ndërtimi i shtëpive të kulturës, etj.);
- Mbrojtja sociale (ndërtimi i kopshteve dhe shtëpive për të moshuarit).

Këtu janë disa shembuj[5] të projekteve të zbatuara të partneritetit publik-privat në nivel lokal:

- Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla të sistemeve të furnizimit me ujë (Kriva Pallankë);
- Menaxhimi i mbeturinave (deponia) - Drislla - Qyteti i Shkupit;
- Tregu (i gjelbër) me shumicë dhe me pakicë (Ohër);
- Modernizimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e fushës sportive, fushes së tenisit; ndërtimi i një kompleksi sportiv - (Aerodrom);
- Parking (Manastir, Kavadar);
- Ndriçimi publik rrugor (Kavadar, Makedonski Brod)
- Ndërtesa administrativo-biznesore (Kriva Pallankë, Gjorçe Petrov)

5) Shembuj të tjerë të projekteve të partenritetit private-publik mund të gjinden në këtë faqe të internetit: http://www.economy.gov.mk/page/javno-privatno-partnerstvo

6. PRONËSIA KOMUNALE

6.1. Pronësia komunale dhe përvetësimi me pronësi komunale

Në bazë të nenit 64 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna ka të drejtën e pronësisë mbi pasuritë (e tundshme dhe të patundshme), mjeteve financiare dhe të drejtat mbi to. Gjithashtu në pronësi të komunave janë edhe shërbimet publike (ndërmarrjet publike dhe institucionet publike) të themeluara nga komuna. Vlera e pronësisë së komunave vlerësohet dhe prezantohet gjatë përgatitjes së llogarisë vjetore. Për të bërë një shpërndarje të drejtë të pronës ndërmjet Republikës dhe komunave, paraprakisht bëhet bilanc i ndarjes. Ata objekte që sipas bilancit të ndarjes janë përcaktuar si objekte të përbashkëta të Republikës dhe komunës, dhe rrjedhimisht nuk mund të ndahen fizikisht, përdoren në bazë të marrëveshjes që nënshkruhet mbi përdorimin e përbashkët dhe mirëmbajtjen e tyre (p.sh. salla sportive, pishina, etj.).

Toka (pjellore dhe jopjellore), si dhe pyjet dhe kullotat në territorin e komunës, ende janë të regjistruara si pronë shtetërore. Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të vitit 2002, komunave u janë caktuar kompetenca të reja që kanë filluar të aplikohen që nga viti 2004. Me qëllim të krijimit të kushteve për të filluar punën për sa i përket ekzekutimit të kompetencave të reja, komunave u jepen pronësi të konsiderueshme, të tilla si shkollat (fillore dhe të mesme), një pjesë e objekteve sportive, ambulancat, objektet e zjarrëfikësve, konviktet e shkollave, zyrat komunale të njësive të disperzuara të ministrive të veçanta, bibliotekat dhe prona të tjera.

Prona komunale mund të ndahet në disa lloje themelore:

- Pasuri e paluajtshme (tokë, deponi/ndërtesa komunale dhe objekte nga fusha e kulturës, shtëpi apo banesa për të jetuar, ndërtesa komerciale, varreza, faltore, objekte sportive dhe pronë tjetër e cila nga natyra e saj është e paluajtshme).
- Pasuri e luajtshme: automjete, objekte lundruese, makina, vegla, inventar, mobilje në zyrat komunale dhe sende të tjera të luajtshme.
- objekte të infrastrukturës publike (rrjeti i ujësjellësit, sistemet e kanalizimeve, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, ndriçimi rrugor, linjat e radio-komunikimit, TV kabllor, etj) që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve komunale deri tek përdoruesit dhe paraqesin të mira me interes publik;
- Pajisje urbane, që paraqesin gjësendet dhe objektet që shërbejnë për të siguruar një shërbim komunal për shpenzimet e përbashkëta (fontanat, monumentet, karriget publike, tabelat reklamuese, çesmet e qytetit, orët, pajisjet për fëmijë dhe fushat të tjera për të luajtur, kontejnerët e mbeturinave, pajisje për ndalesat e autobusit, etj).
- Financat (paratë, bonot e thesarit, letrat me vlerë, llogaritë rrjedhëse, aksionet, etj.).
- Të drejtat (e drejta për pronën intelektuale dhe/ ose industriale, etj.).

6.2. Disponimi me pronësinë e komunës

Pronësia e komunës dhe disponimi me pronësinë komunale rregullohen në Kapitullin VIII, nenet 64-68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Neni 66 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale rregullon shitjen e pronës (të paluajtshme dhe të paluajtshme) së komunës. Shitja mund të kryhet vetëm me anë të ofertimit publik në përputhje me ligjin, në këtë rast, me Ligjin për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale. Përkatësisht, për shitjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, përveç dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenin 67 të Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale, në mënyrë adekuate zbatohen edhe dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme dhe shitjen e pasurive të luajtshme nëpërmjet dhënies së ofertës publike përmes mënyrave elektronike. Dhënia e përdorimit të gjërave në pronësi të komunës rregullohet me nenin 67 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit sendet në pronësi të komunës mund tu jepen për përdorim subjekteve

tjera përmes ofertës publike. Prona e komunës nuk mund të jepet nën hipotekë, nëse shërben për të kryer një aktivitet me interes publik.

Shitja e pasurisë së paluajtshme dhe pasurisë së luajtshme në pronësi të komunës

Komuna, në bazë të vendimit të këshillit të komunës, mund të shes gjësende në pronësi të komunës vetëm përmes dhënies përmes sistemit elektronik për ankand publik, me të cilin menaxhon dhe operon Ministria e Financave, gjegjësisht Zyra për çështje pronësore-juridike, në pajtueshmëri me ligjin (Ligjin për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale). Përkatësisht, për shitjen e pasurisë së tundëshme dhe të patundëshme, si dhe për dhënien me qira të pasurive të patundëshme, përveç dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenin 67 të Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale, në mënyrë adekuate zbatohen edhe dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të patundëshme dhe shitjen e pasurive të tundëshme nëpërmjet dhënies së ofertës publike përmes mënyrave elektronike përgjatë shitjes dhe dhënies me qira të pasurive të patundshme dhe shitjen e pasurisë së luajtshme njësive të qeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit.

Procedura për ankand elektronik zbatohet nga Komisioni për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me anë të njoftimt të lëshuar paraprakisht në sistemin elektronik për ankand publik dhe në dy gazeta ditore, të cilat shypen në gjuhën maqedonase, dhe dalin të paktën tre muaj para datës së publikimit të shpalljes, si dhe në një gazetë ditore, e cila shtypet në gjuhën që flitet nga së paku 20% e qytetarëve që jetojnë në komunën në territorin e së cilës shtrihen pasuritë e patundshme që janë subjek i shpalljes dhe del së paku 3 muaj para ditës së publikimit të shpalljes.

Për mallin që është subjekt i ankandit publik, mund të aplikojnë për pjesëmarrje të gjithë personat e interesuar vendas dhe të huaj, persona fizik dhe juridik që mund të përvetësojnë pronësi nga pasuritë e patundshme të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjin, dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ankandin publik. Çmimi i shitjes së mallrave nuk duhet të jetë më i vogël se vlera e tyre e tregut, e cila duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjin për Vlerësim. Mjetet financiare të fituara nga shitja e pronës në pronësi të komunës mund të investohen vetëm për blerjen e objekteve të reja ose rindërtimin e pronës ekzistuese në pronësi të komunës.

Dhënia me qira e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës

Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në pronësi të komunës është e rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por duke marrë parasysh dispozitat e nenit 67 të Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunal. Kështu, për të dhënë me qira pronën e paluajtshme duhet të zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e këtij ligji. Zbatimi adekuat i Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale, nënkupton se komuna mund të jep me qira pasurinë e paluajtshme të cilën ajo ka ndaluar së përdoruri, me çka duhet të ketë kujdes që të mos e dëmtojë funksionin e saj si komunë. Pasuritë e paluajtshme, për të cilat përgjithmonë ka pushuar nevoja për t'i përdorur, dhe njëkohësisht nuk mund të shiten apo këmbehen, apo asnjë komunë ose organ tjetër shtetëror apo subjekte juridike të themeluara nga komuna dhe shteti nuk kanë nevojë për to, mund të jepen me qira.

Për dhënien e pasurive të patundshme me qira duhet të vendos këshilli i komunës, përderisa kryetari mund të vendosë për një pasuri të paluajtshme, apo për një pjesë të një pasurie të paluajtshme që të jepet me qira pas përfundimit të orarit të punës së komunës (me ose pa pajisje). Në ndërkohë, duhet të ketë kujdes që të mos e pengojë ushtrimin e funksionit të komunës. Dhënia e pasurisë së paluajtshme me qira duhet të bëhet përmes ankandit publik elektronik. Pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira nuk mund të jepen me nënqira. Shuma e çmimit total të qirasë fillestare është 0.5% e vlerës së përgjithshme të vlerësuar për qiranë mujore të pasurisë së paluajtshme. Vlera e pasurisë së paluajtshme përcaktohet nga një vlerësues i autorizuar, në përputhje me Ligjin për Vlerësim. Për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira me ankand elektronik, zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën

Shtetërore dhe Pronën Komunale, me të cilat është rregulluar procedura për shitjen e pasurive të patundshme me anë të ankandit publik elektronik.

Dhënia për përdorim e pronës komunale

Në bazë të nenit 67 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, pasuria në pronësi të komunës mund të përdoret nga subjektet e tjera përmes ankandit publik, në përputhje me ligjin. Sipas Nenit 21 të Ligjit për Përdorimin dhe Disponimin me Pronën Shtetërore dhe Pronën Komunale, pronën e paluajtshme në pronësi të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe komunës së Qytetit të Shkupit, Këshilli i komunës përkatëse, gjegjësisht Këshilli i komunave në qytetin e Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupi, me vendim, mund ta japë për përdorim përkohësisht ose me afat të pacaktuar, me ose pa kompensim, organeve shtetërore dhe personave juridik të themeuar nga shteti. Për ndërprerjen e përdorimit të pasurive të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni vendos këshilli i komunës ose këshilli komunal, respektivisht këshilli i komunave në qytetin e Shkupit dhe Këshillit i Qytetit të Shkupit. Vendimi i këshillit komunal, respektivisht vendimi i këshillit të komunave në qytetin e Shkupit dhe vendimi i Këshillit të Qytetit të Shkupit, është bazë për regjistrimin në Regjistrin publik të regjistrimit të të drejtave të patundshëmrive.

6.3. Regjistri i pronës komunale

Komuna është e detyruar të mbajë evidencë mbi pronën dhe të azhurnojë ndryshimet. Komuna për pronën mban një regjistër dhe pronën e shpreh në bilanc pronësor. Në fund të çdo viti kalendarik, komuna kryen një inventar të pasurive materiale. Në praktikë, ka raste në të cilat paraqitet nevoja për një regjistrim shtesë, veçanërisht kur dorëzohen detyrat e menaxherëve të pasurive, kur bëhen ndryshime statutore ose të ngjashme. Regjistrimi është me rëndësi të madhe për shkak të planit të përgjithshëm dhe zhvillimor për menaxhimin e pronës dhe paraqet një faktor të rëndësishëm në planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.

Prona e komunës është e larmishme dhe e ndryshueshme në dimezionin kohor. Komuna është e detyruar të azhurnojë ndryshimet dhe të regjistrojë zhvillimin e pronës së saj - së bashku me regjistrimin aktual të të gjitha ndryshimeve kontraktuale. Kjo nuk është vetëm një detyrë ligjore, por është edhe në interes të komunës. Prona është e regjistruar në komunë, sipas ligjit, por për siguri më të madhe, komisioni i regjistrimit duhet të mbikëqyrë pasurinë. Para fillimit regjistrimin të pronës, rregulli themelor është që të kontrollohet nëse çdo pronë e patundshme është e regjistruar në regjistrin publik të Autoritetit gjeodezik (kadastral). Aktivitetet e regjistrimit fillojnë me krijimin e një Komisioni të Regjistrimit. Për punën e suksesshme të Komisionit të Regjistrimit, përgatitet një plan dhe udhëzim për përgatitjen e regjistrimit. Gjendja e regjistrimit paraqitet në listat e regjistrimit. Është më praktike kur regjistrimi bëhet në lista të veçuara të regjistrimit. Për shembull, lista e veçuar e regjistrimit për objektet ndërtimoer, lista e veçuar për tokën, për sendet e luajtshme, për inventar të madh dhe të vogël.

Regjistrimi kryhet edhe për mjetet monetare. Me regjistrimin e mjeteve monetare përfshihen të gjitha mjetet monetare që në ditën e regjistrimit janë në llogaritë rrjedhëse në bankat që i posedon komuna, në arkën e komunës, si dhe në kambialet dhe aksionet që i posedon komuna. Pas përfundimit të regjistrimit, përgatitet një raport mbi regjistrimin. Anëtarët e këshillit komunal, në një nga seancat e para të këshillit komunal, duhet të marrin vendim për inspektim të plotë dhe kontroll të përhershëm të regjistrit të pronës komunale. Regjistri i pronës regjistron të gjithë pronën në pronësi të komunës (tokat, ndërtesat dhe asetet).

6.4. Mbrojtja e pronës

Komuna e mbron pronën nga ndikimet natyrore dhe ndikimet tjera sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Për të mbrojtur pronën, komuna duhet të marrë masat e duhura, edhe atë: mirëmbajtjen preventive të objekteve, masat për mospagesë të taksave në lidhje me dhënien me qira të pronës, masat kundër korrupsionit, masat kundër vjedhjes dhe dëmtimit, masat për mbrojtje nga ndikimet natyrore dhe të tjerët. Prona komunale

duhet të sigurohet. Gjatë asaj, është e nevojshme të shqyrtohen llojet e rreziqeve që i kanosen dhe nën cilët kushte. Gjithmonë duhet të kihet parasysh se borxhli nuk janë vetëm njerëzit që nuk i kanë paguar komunës çmimin e blerjes apo atë të qirasë, por edhe ata që janë të obliguar për kryerjen e punëve të caktuara për komunën. Për këtë qëllim është e nevojshme që të ndërmerren masat e duhura sa më shpejt ashtu që të kryhen pagesat e borxheve të papaguara ndaj komunës dhe pagesat për punët tjera brenda afateve të përcaktuara në kontrata.

- Debatin publik dhe miratimin e buxhetit të komunës për vitin e ardhshëm fiskal dhe Vendimin për ekzekutimin e buxhetit të komunës për vitin e ardhshëm fiskal nga Këshilli komunal jo më vonë se 31 dhjetori i vitit aktual.

Gjatë ekzekutimit të buxhetit në vitin aktual fiskal, kryetari i komunës mund t'i propozojë këshillit amendamente dhe plotësime të buxhetit - ribalancimi që miratohet jo më vonë se 15 nëntori në vitin aktual fiskal. Ribalancimi i buxhetit të komunës miratohet sipas procedurës identike me procedurën për miratimin e buxhetit të komunës.

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, buxheti për vitin e ardhshëm miratohet nga këshilli komunal me propozim të kryetarit deri më 31 dhjetor të vitit aktual. Nëse këshilli komunal për çfarëdo arsye nuk e miraton buxhetin brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai është i detyruar të miratojë një Vendim mbi financimin e përkohshëm dhe planin financiar për zbatimin e tij në tremujorin e parë të vitit. Komuna është e detyruar ta dorëzojë buxhetin në Ministrinë e Financave brenda 15 ditëve nga miratimi i buxhetit.

11.2. Përmbajtja e buxhetit

Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale përbëhet nga një pjesë e përgjithshme, një pjesë e veçantë dhe një pjesë e zhvillimit. Pjesa e përgjithshme përbëhet nga totali i të hyrave dhe të ardhurave të tjera dhe totali i shpenzimeve dhe daljeve të tjera të buxhetit për vitin fiskal, si dhe parashikimet globale të të hyrave, të të ardhurave, shpenzimeve dhe harxhimeve për dy vitet e ardhshme (përfshirë këtu edhe deficitin e planifikuar). Përveç kësaj, pjesa e përgjithshme përmban:

- bilancin e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve;

- klasifikimin funksional të shpenzimeve;
- bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale - operative;
- bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve kapitale

Pjesa e veçantë e Buxhetit përmban një plan të fondeve të miratuara sipas programeve, nën-programeve dhe artikujve për vitin fiskal. Në pjesën e veçantë të buxhetit, shpenzimet paraqiten sipas klasifikimit të shpenzimeve të përcaktuara nga Ministri i Financave, të grupuara sipas përdoruesve dhe programeve. Programet përcaktohen me shkronja në qarkoren e buxhetit. Pjesa e zhvillimit, megjithatë, përmban planet e programeve të zhvillimit të paraqitura përmes projekteve të zhvillimit. Pjesa e zhvillimit të buxhetit paraqet planet afatmesme për programet e zhvillimit të destinuara për investime të zhvillimit të miratuara nga Këshilli komunal. Plani i programeve zhvillimore duhet të përmbajë projeksionet afatmesme të fondeve të aprovuara sipas:

- programeve dhe nën-programeve të ndara buxhetore,
- viteve në të cilat do të realizohen të njejtat dhe
- burimet e financimit, respektivisht buxhetet.

Pjesa e përgjithshme e buxhetit komunal

Pjesa e përgjithshme e buxhetit komunal duhet të jetë e pregatitur në atë mënyrë që të ardhurat dhe shpenzimet e projektuara të paraqiten me qëllim që të vërtetojnë deficitin, si diferencë e tyre dhe vërtetimin e të ardhurave për financimin e tij dhe financimin e daljeve (pagesave). Bazuar në marrëveshjet për huamarrje ose zgjidhje për emitimin e letrave nga vlera në Pjesën e përgjithshme të buxhetit për vitin e ardhshëm fiskal është e nevojshme që tregohen mjetet me të cilat do të financohen shpenzimet më të larta ose deficit që planifikohet.

Gjatë përgatitjes së projekt-buxhetit komunal, kur nuk planifikohen të ardhura të bazuara në huamarrje, atëherë shpenzimet planifikohen në nivelin e të ardhurave të planifikuara dhe komuna nuk tregon deficit.

Pjesë e veçantë

Në pjesën e veçantë të buxhetit planifikohen fondet e aprovuara sipas programeve, nën-programeve dhe artikujve me paraqitje të shpenzimeve në përputhshmëri me klasifikimit ekonomik dhe funksional. Shpenzimet e financuara nga grantet e dedikuara dhe bllok dhe nga të ardhurat prej aktiviteteve të vetëfinancimit duhet të përafrohen me nevojat dhe kërkesat e institucioneve publike lokale.

Plani i programeve të zhvillimit

Plani i programeve të zhvillimit është një përmbledhje afatmesme e programeve që janë të destinuara për investime zhvillimore dhe i njejti përmban projeksionet afatmesme të mjeteve të miratuara në komunë, sipas programeve të ndara buxhetore dhe nën-programeve, përkatësisht për vitet në të cilët do të zbatohen dhe burimet e financimit të tyre. Në përputhshmëri me Neni 21-b të Ligjit për Buxhetet, planet zhvillimore duhet të përgatiten dhe miratohen nga organet e komunës, edhe atë sipas procedurës së mëposhtme:

- Kryetar i komunës përgatit projekt-plan për programet e zhvillimit në përputhje me udhëzimet e Qarkores dhe të njejtin e paraqet për miratim në Këshillin komunal jo më vonë se më 20 tetor të vitit aktual
- Këshilli komunal miraton Projekt Planin e Programeve për Zhvillim jo më vonë se më 15 nëntor të vitit aktual.

Gjatë planifikimit të nën-programit të zhvillimit duhet të jepet një shpjegim i detajuar, i cili duhet të përmbajë objektivat që do të arrihen me zbatimin e tij, aktivitetet e planifikuara për vitet e ardhshme dhe rezultatet e zbatimit të të njejtave. Për secilin nën-program, komuna ka për detyrim që të përcaktojë tregues të matshëm që do të vlerësojë rezultatet e zbatimit të aktiviteteve të parapara me nën-programet e zhvillimit.

Nëse në nën-programin e zhvillimit financohen projekte me mjete nga fondet e BE-së që dalin nga pesë komponentët e IPA-s (I - Asistenca e Tranzicionit dhe Ndërtimi i Institucioneve, II - Bashkëpunimi Ndërkufitar, III-Zhvillimi rajonal, IV - Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, V – Zhvillimi Rural), komuna duhet që mjetet e siguruara përmes IPA-s t'ii paraqesë në llogarinë e donacionit, duke treguar se burimi i financimit është IPA.

11.3. Burimet e financimit të komunave

Burimet e financimit të komunave janë të rregulluara me Ligjin për financimin e vetëqeverisjes lokale (Gazeta Zyrtare No. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09, 47/11 dhe 192/15), edhe atë si burime vetanake të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, të ardhurat nga donacionet dhe kontributet, të hyrat nga grantet (tatimi i vlerës së shtuar, tatimi i destinuar, kapital, bllok dhe për kompetencën e deleguar) dhe të ardhurat nga huamarrja dhe/ ose lëshimi e letrave me vlerë.

Burimet vetanake të të ardhurave janë të ardhurat e mbledhura nga taksat lokale, tatimet lokale, kompensimet lokale dhe të ardhurat nga prona. Tatimet lokale përfshijnë: tatimin në pronë; tatimi mbi trashëgimin dhe dhuratën; tatimi mbi pasuritë e patundshme. Taksat lokale janë: taksat komunale; taksat administrative dhe taksat tjera lokale të përcaktuara me ligj. Kompensimet lokale janë: kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore; kompensimet nga veprimtaria komunale dhe kompensimet për planet hapësinore dhe urbanistike.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë në vlerë prej 3% të tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat e individëve që jetojnë dhe banojnë në komunë dhe të gjithë shumën e tatimit mbi të ardhurat personale të individëve që merren me zanate sipas vendit të regjistrimit të veprimtarisë.

Me vendim të këshillit komunal rregullohet qëllimin, zona, koha për futjen e vetë-kontributit, shuma e përgjithshme e mjeteve të mbledhura fianciare, paguesit e vetë-kontributit, personat e liruar nga pagesa e kontributit, shuma e vetë-kontributit (baza dhe norma), metoda për llogaritjen dhe kryerjen e mbikëqyrjes së qytetarëve mbi përdorimin e destinuar të mjeteve fianciare. Donacionet, nga ana tjetër, regjistrohen në pronën e komunës.

Të ardhurat prej tatimit mbi vlerën e shtuar sigurohen në lartësi prej 4.5% të tatimit total të vlerës së shtuar të mbledhur në vitin paraprak fiskal në dispozicion të komunave. Shpërndarja e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar kryhet sipas një formule në të cilën të paktën 50% është sipas kriterit për kokë banori dhe kritere të tjera të përcaktuara nga Rregullorja për metodologjinë për shpërndarjen e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar të miratuar nga Qeveria me propozimin e Ministrit të Financave me pëlqimin paraprak të Komisionit për të monitoruar zhvillimin e sistemit të financimit të komunave më së voni deri më 30 qershor të vitit aktual për vitin e ardhshëm . Duke marrë parasysh dallimet e konsiderueshme të Qytetit të Shkupit përballë komunave tjera në Republikën e Maqedonisë me Dekretin e Qytetit të Shkupit përcaktohen kritere specifike me të cilat korrigjohen ato dallime.

Granti i dedikuar përdoret për të financuar një aktivitet specifik, ndëra granti bllok për financimin e kompetencave në kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve, arsim dhe kujdes shëndetësor. Për këto burime të të ardhurave të komunave, ministritë kompetente përgatisin një metodologji për përcaktimin e kritereve për ndarjen e tyre.

Grantet kapitale përdoren për të financuar projekte investimi bazuar në një program të përcaktuar nga Qeveria. Granti për kompetencën e deleguar përdoret për të financuar kompetencën e deleguar nga organi i administratës shtetërore tek kryetari i komunës.

Komuna mund të planifikojë të ardhura nga huamarrja në vend dhe jashtë saj. Huamarrja është e mundur vetëm me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e përcaktuar në bazë të mendimit të Ministrisë së Financave. Komuna mund të merr hua me lëshimin e letrave me vlerë. Në vitin 2011 është përgatitur një udhëzues për lëshimin e bonove komunale, në të cilin është shpjeguar korniza ligjore për huamarrje përmes obligacioneve komunale dhe lëshimin e obligacioneve përmes ofertave publike dhe private.

Në rastin e huamarrjes afatshkurtër, huatë paguhen brenda 12 muajve nga dita e lidhjes së kontratës huamarrëse. Gjatë huamarrjes afatshkurtër, borxhi i përgjithshëm i komunës i bërë në bazë të huamarrjes afatshkurtër dhe kredisë afatshkurtër nga Buxheti Qendror gjatë vitit fiskal nuk mund të tejkalojë 30% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit aktual operativ të komunës në vitin fiskal paraprak.

Për huamarrjen afatgjatë, këshilli komunal e miraton huamarrjen afatgjatë, pas një dëgjimi publik të mbajtur më parë në komunë. Vendimi i këshillit është i vlefshëm vetëm nëse marrëveshja e huazimit ose dhënia e garancisë realizohet në vitin fiskal në të cilin është miratuar. Gjatë huamarrjes afatgjatë, totali i shlyerjes vjetore të borxhit (kapitali, interesi dhe kostot tjera) që bëhet në bazë të borxhit afatgjatë dhe huamarrjes afatgjatë nga Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë nuk mund të kalojë mbi 30% të të ardhurave totale të buxhetit aktual operativ të komunës në vitin e kaluar fiskal. Shuma totale e borxhit afatgjatë të papaguar të komunës, duke përfshirë edhe të gjitha garancitë e lëshuara, nuk mund të tejkalojë shumën e të ardhurave totale të buxhetit aktual operativ të komunës në vitin paraprak.

11.4. Paqëndrueshmëria financiare e komunave

Paqëndrueshmëria financiare e komunës ndodh nëse:

- Llogaria e komunës është bllokuar për më shumë se gjashtë muaj, ose
- Në periudh prej gjashtë muajsh, në mënyrë të vazhdueshme për çdo muaj, shuma totale e borxheve gjatë 60 ditëve kalon 80% të të ardhurave të buxhetit themelor të komunës në vitin paraprak.

Gjatë kësaj, kryetari është i detyruar të miratojë vendim për të shpall joqëndrueshmëri financiare brenda pesë ditëve nga data e ndodhjes së njërës nga arsyet e dhëna më sipër dhe për më tepër, kryetari i komunës do të informojë këshillin, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokal dhe Komunitetit e njësitive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë, brenda tri ditëve nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e paqëndrueshmërisë financiare.

Ministria e Financave, megjithatë, brenda pesë ditëve pas marrjes së njoftimit nga kryetari i komunës, formon një trup koordinues të përbërë nga pesë anëtarë: kryetari dhe një anëtar i Ministrisë së Financave, një antar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe dy anëtarët e Komunitetit të njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë. Pas themelimit të Trupit Koordinues, kryetari i komunës dorëzon një propozim-plan të masave për tejkalimin e paqëndrueshmërisë financiare më së voni brenda 15 ditëve. Trupi koordinues i jep mendim kryetarit të komunës mbi propozim-planin e masave për tejkalimin e paqëndrueshmërisë financiare brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit. Paqëndrueshmëria financiare konsiderohet si e tejkaluar nëse llogaria e komunës zhbllokohet dhe shuma totale e detyrimeve të pazgjidhura për 60 ditë nuk kalon 80% të të ardhurave të realizuara të buxhetit komunal në vitin paraprak.

12. TRANSPARENCA FISKALE

Parimet kryesore të qeverisjes së mirë: transparenca dhe llogaridhënia për shpenzimet publike janë pika e fillimit për të informuar publikun në lidhje e atë se si mbildhen, ndahen dhe të shpenzohen paratë e tij. Si parakusht për një shoqëri të shëndoshë demokratike, përveç ransparencës dhe llogaridhënies, pjesëmarrja në vendimmarrje është tejet e rëndësishme sepse rrit besimin e qytetarëve që qeveria i menaxhon në mënyrë efektive paratë e tyre.[6] Transparenca fiskale është thelbësore për menaxhimin efektiv të financave publike dhe ndihmon në ndërtimin e besimit të publikut, në funksionimin e institucioneve publike dhe kontribuon në qëndrueshmërinë e zbatimit të politikave publike. Transparenca fiskale është pjesë e përkufizimit më të gjerë të transparencës, por njëkohësisht paraqet term më i gjerë se termi i transparencës buxhetore.

12.1. Transparenca buxhetore

Transparenca buxhetore paraqet hapje ndaj publikut për strukturën dhe funksionimin e pushtetit lokal/ qendror, qëllimet në politikat fiskale, llogaritë e sektorit publik dhe projeksionet fiskale. Transparenca buxhetore shpjegon procesin me të cilin preken autoritetet dhe qytetarët nga ana tjetër, dhe e përmirëson integritetin në lidhje me profesionalizmin dhe llogaridhënien në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj, si dhe cilësinë e nevojave të tyre të shpërndarjes dhe prioritetet e qytetarëve.[7] Në Maqedoni, në një pjesë e kufizuar, masa të caktuara për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave me publikun janë të rregulluara dhe të garantuara nga dy ligje, Ligji për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik që u miratua në vitin 2006 dhe Ligji mbi Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik të miratuar në vitin 2014.[8]

Arsyet për nivelin relativisht të ulët të transparencës së buxhetit në mes të komunave në Maqedoni

- Në Maqedoni, ende ekzistojnë komuna që nuk kanë faqe zyrtare të interneti ose që nuk kanë faqe funksionale.
- Ka ende faqe zyrtare të komunave që janë njëgjuhëshe.
- Gati 20% e komunave nuk përgjigjen pas paraqitjes së një kërkese për qasje në informata publike.

Ligji për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik[9] siguron publicitet dhe hapje në funksionimin e mbajtësve të informatave dhe u mundëson personave fizikë dhe juridikë të ushtrojnë të drejtën për qasje të lirë në informatat publike. Si një informacion publik, ligji përcakton çdo informacion të çfarëdo forme të krijuar ose mbajtur nga mbajtësi i informacionit në përputhje me kompetencat e tij.

Përveç kësaj, në vitin 2014 u prezantua dhe filloi të zbatohej një politikë e re publike për hapjen dhe përdorimin e të dhënave të sektorit publik, përmes të cilës autoritetet dhe institucionet publike detyrohen të publikojnë publikisht të dhënat në përputhje me kompetencat e tyre. Për të inkurajuar inovacionin, për të krijuar përmbajtje të re, për të inkurajuar zhvillimin ekonomik, gjithashtu arrihet dhe rritet llogaridhënia dhe transparenca e sektorit publik.[10] Për më tepër, përveç obligimit për publikimin e të dhënave, çdo autoritet dhe institucion është i detyruar të azhurnojë rregullisht të ato, për të siguruar funksionimin e faqeve të internetit ku ato publikojnë të dhënat si dhe funksionalitetin e faqes së internetit të katalogut qendror të sektorit publik. Të gjitha të dhënat që zbulohen për përdorim janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.otvorenipodatoci.gov.mk.[11]

6) http://www.mkbudget.org/docs/OBS2015-CS-Macedonia-English.pdf.
7) http://kbm.mk/.
8) http://cea.org.mk/documents/CEA_IDSCS_Transparency_paper_MK.pdf
9) Ligji për Qasjen e Lirë në Informacion të Karakterit Publik. Teksti redaktues i rafinuar. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 6/10
10) Ligji për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 27/14
11) http://cea.org.mk/documents/CEA_IDSCS_Transparency_paper_MK.pdf

12.2. Dokumente buxhetore dhe buxhetimi me pjesëmarrje

Sipas disa organizatave që janë të angazhuar për transparencë të buxhetit, të tilla si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Partneritetit (OPSE), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Grupi i punës për hapjen fiskale të Partneritetit të hapur qeveritar, Partneriteti ndërkombëtar për buxhetin, Iniciativa globale për transparencën fiskale, standardet ndërkombëtare që duhet të plotësohen për procesin e buxhetit të komunave për t'u konsideruar transparente, përcaktojnë publicitetin më shumë dokumenteve dhe fazave të miratimit të buxhetit. Edhe pse ndryshojnë sipas emrit, formës dhe përmbajtjes, këto dokumente janë:[12]

- Projekt-buxheti
- Buxheti i miratuar
- Buxheti i qytetarëve
- Raportet tremujore
- Raporti vjetor për punën e komunës
- Llogaria përfundimtare
- Raporti i auditimit.

Projekt-buxheti

Projekt-buxheti i komunave dhe institucioneve të tjera publike është një dokument i rëndësishëm që është vendimtare për informim më të mirë të qytetarëve dhe për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në marrjen e sugjerimeve. Në një shoqëri demokratike, shoqëria civile ka mundësi të ndikojë në hartimin dhe zbatimin e politikave në fusha të tilla si ulja e varfërisë, shëndetësia, arsimi, barazia gjinore dhe mjedisi jetësor.[13] Për këtë qëllim, publiku duhet të ketë qasje në informatat mbi aktivitetet që pushteti lokale synon të zbatojë dhe në çfarë mënyre do të financohen të njejtët. Komuna ka miratuar këto vendime në emër të të gjithë qytetarëve dhe për këtë arsye, është thelbësore që ajo të sigurojë një shpjegim të plotë të tatimeve të mbledhura, huamarrjes dhe shpenzimeve, për të miratuar buxhetin në Këshilli me qëllim që të mundësojë debat të informuar publik dhe diskutim e miratim të informuar legjislativ.

Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje paraqet një proces të vendimmarrjes në komunitet në një nivel të caktuar të qeverisjes (qendrore / lokale) përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e dhënies së ideve dhe sugjerimeve për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve publike financiare. Ky është një proces demokratik në të cilin komuniteti, në bashkëpunim me pushtetin lokal, vendos direkt se si të shpenzojë një pjesë të buxhetit komunal.[14] Si vegël për buxhetimin me pjesëmarrje është pikërisht forumi buxhetor i komunave.

Forumi buxhetor ka për qëllim të sjellë së bashku palët e interesuara dhe për të filluar diskutimin e planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, si dhe definimin e qëllimeve strategjike dhe prioriteteve të buxhetit. Ky forum është hartuar si një ngjarje vjetore me qëllim që të inkurajojë një debat publik mbi politikat buxhetore dhe prioritetet e komunave. Në mënyrë që të rrisë përfshirjen në planifikim, zhvillim dhe zbatim të buxhetit të komunave, ai duhet të realizohet në 6 sesione të forumit:

1. Sesioni për themelimin e forumit, në të cilin bëhet diskuptimi i prioriteteve të buxhetit komunal;
2. Sesioni në të cilin do të diskutohen të ardhurat e komunës;
3. Sesioni në të cilin do të diskutohen shpenzimet buxhetore prioritare të komunës;
4. Sesioni në të cilin do të zgjidhet linja buxhetore (investimet kapitale);

12) ibid
13) Indeksi i Buxhetit të Hapur (OBI)
14) http://www.forumivozaednicata.com.mk/download/%D0%BEpstinski-budzet.pdf

5. Sesioni pasues, në të cilin do të jepet një raport se si zbatohen projektet e financuara nga buxheti komunal.[15]

Buxheti i miratuar

Dallimet në mes të Projekt-buxhetit dhe Buxhetit të miratuar mund të shpien deri tek mundësia për ndryshime në periudhën nga miratimi i propozimit deri te miratimi i buxhetit si një formë e pjesëmarrjes aktive nga palët e interesuara. Buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale përfaqëson një plan vjetor të të hyrave, flukseve tjera hyrëse dhe fondeve të miratuara dhe i njejti përfshin:

- Buxheti themelor,
- Buxheti i granteve,
- Buxheti i donacioneve,
- Buxheti i huamarrjes dhe
- Buxheti i aktiviteteve të vetëfinancimit.[16]

Publikimi i buxhetit të miratuar të komunave në Republikën e Maqedonisë rregullohet me nenin 54 (2) të Ligjit për Buxhetet[17] dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Komunës.

Buxheti qytetar

Buxheti komunal zakonisht është i gjatë dhe kompleks dhe shoqërohet me një numër të madh të dokumenteve mbështetëse të detajuara. Kështu, edhe për ekspertët teknikë, kuptimi i buxhetit është i vështirë dhe kërkon kohë. Prandaj, është thelbësore që komunat të jenë proaktive për të ndihmuar publikun e gjerë që të kuptojë buxhetin. Me qëllim që buxheti komunal të vihet në dispozicion zë publikut, buxheti qytetarë është një vegël që lehtëson këtë proces. Buxheti qytetar paraqet një botim që në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme përfaqëson buxhetin. Publikimi i tij i dedikohet enkas publikut të gjerë dhe joprofesional.

Në Republikën e Maqedonisë, komunat nuk kanë asnjë praktikë për të krijuar një buxhet qytetar. Në këtë drejtim, për herë të parë në vitin 2017 komunat e para që krijuan buxhet qytetar për shpenzimin e fondeve publike janë Komuna e Strumicës dhe Komuna Qendrë, të cilat e bënë këtë mbu buxhetin e vitit 2017.[18]

Raportet tremujore

Raportet tremujore gjatë vitit japin një pasqyrë të zbatimit të buxhetit për çdo tremujor të një viti buxhetor. Qëllimi i raporteve tremujore është të sigurojë një masë periodike të trendeve në të hyrat dhe shpenzimet dhe të shikojë nëse ka devijime nga pritjet. Ata japin një kontribut të rëndësishëm në transparencën e buxhetit, sepse ata kërkojnë nga pushteti lokal që të zhvillojë ekspertizë për sistemin dhe personelin, gjë që është e nevojshme për monitorimin e shpenzimeve totale të buxhetit dhe trendet e të ardhurave. Kjo aftësi për të ndjekur trendet e shpenzimeve dhe të të ardhurave mund të sigurojë informacion të rregullt për politikëbërësit dhe publikun. Këto raporte bëjnë të mundur për të parë nëse strategjia fillestare e buxhetit ka nevojë për përshtatje ose ndryshime.

Kryetari i komunës dorëzon në Ministrinë e Financave dhe në Këshillin e komunës raporte tremujore me shpjegim për ekzekutimin e buxhetit brenda një muaji pas përfundimit të tremujorit. Pas miratimit të raporteve, kryetari i komunës e informon publikun për përmbajtjen e raporteve. Nëse raportet nuk miratohen, kryetari i këshillit publikisht shpall arsyet për mospranimin e tyre. Disponueshmëria e raporteve tremujore

15) http://www.forumivozaednicata.com.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=215&Itemid=90&lang=mk
16) Законот за буџетите (Службен весник на Република Македонија, бр. 64/05, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11 и 171/12)
17) http://www.finance.gov.mk/files/u6/_____5.pdf
18) http://www.strumica.gov.mk/index.php/mk/januari-4/3590-2017-04-04-12-47-07
http://opstinacentar.gov.mk/%D0%A1%D0%B5%D1%80%D0%B2%D0%B8%D1%81%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%B3%D1%80%D0%B0%D1%93%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5/%D0%9D%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8/ArtMID/549/ArticleID/2244

të komunave në Maqedoni është kryesisht përmes Kërkesës për Qasje në Informacionin Publik (BPJJK), përderisa vetëm 20% e komunave i kanë publikuar raportet tremujore në Gazetën Zyrtare të komunës në vitin 2017.

Raporti vjetor për ekzekutimin e buxhetit të komunës

Raporti vjetor është një raport që mbulon atë që është shpenzuar në të vërtetë dhe të mbledhura në krahasim me atë që është buxhetuar. Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit të komunave në Maqedoni përgatitet në pajtim me Ligjin për Buxhetet. Është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të Raportit Vjetor dhe Llogarisë Përfundimtare të komunës. Llogaria Përfundimtare është një raport i detajuar mbi shpenzimet aktuale dhe pagesat e të ardhurave nga ana e komunës, përderisa Raporti Vjetor për buxhetin e komunës[19] përbëhet nga:

- llogaria përfundimtare;
- raporti mbi pasuritë, kërkesat, detyrimet dhe burimet e mjeteve financiare me vlerat e tyre, respektivisht inventarin;
- raporti mbi realizimin e programeve të investimeve,
- ekzekutimi në pjesën e granteve bllok të destinuara, grantet kapitale, si dhe kompetencat e deleguara;
- raporti nga kontabilisti përgjegjës për të verifikuar saktësinë dhe besueshmërinë e faturës përfundimtare.

Llogaria përfundimtare

Llogaria përfundimtare është një raport i detajuar mbi konsumin aktual dhe mbledhjen e të hyrave nga komuna. Ky dokument ofron një pasqyrë të asaj që është bërë kundrejt asaj të planifikuar, duke përfshirë ribalancimin e buxhetit nëse ai ekziston. Kryetari i komunës dorëzon llogarinë vjetore për miratim në këshillin e komunës, më së voni deri më 28 shkurt të vitit të ardhshëm. Këshilli miraton llogarinë vjetore deri më 15 mars të vitit aktual, për vitin paraprak dhe e dërgon atë në Ministrinë e Financave, jo më vonë se 31 marsi i vitit aktual. Pas miratimit të llogarisë vjetore, kryetari i komunës e informon publikun për përmbajtjen e tij.[20] Publikimi i llogarisë vjetore të komunave në Republikën e Maqedonisë rregullohet me nenin 54 (2) të Ligjit për Buxhetet dhe i njejti publikohet në Gazetën Zyrtare të komunës. Çfarë është edhe më me rëndësi, përdoruesit e buxhetit janë të detyruar që llogaritë përfundimtare ti publikojnë në faqen e vet të internetit brenda 15 ditëve nga dorëzimi i llogarive përfundimtare në Regjistrin Qendror. Shfrytëzuesit buxhetorë janë të detyruar të publikojnë llogaritë vjetore për vitin 2016 të faqen e tyre të internetit.[21]

Raporti i auditimit

Raporti i Auditimit i Zyrës Shtetërore të Auditimit (ZShA) është një raport i pavarur i auditimit të jashtëm dhe duhet ti sigurojë publikut informata të sakta dhe reflektuese nga raporti i komunës mbi mënyrën e shpenzimit të fondeve publike gjatë vitit të kaluar. Raporti i auditimit gjithashtu tregon nëse pushteti lokal është harmonizuar me menaxhimin financiar dhe dispozitat ligjore gjatë vitit buxhetor. Prandaj, raporti i auditimit është një element kyç në mbylljen e hendekut të llogaridhënies së komunës.[22]

19) Ligji për Financimin e NJVL-së, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 61/2004
20) Ibid.
21) Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kontabilitet për Buxhetet dhe Përdoruesit e Buxhetit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 170/17).
22) Indeksi i Buxhetit të Hapur (OBI)

KORNIZA LIGJORE

Dispozitat themelore ligjore dhe nënligjore në fushën e vetëqeverisjes lokale janë:[23]

- Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/1997)
- Ligji për Ratifikimin e Protokollit Shtesë të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale për të Drejtën e Pjesëmarrjes në Punët e Qeverisjes Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 130/2015)
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002);
- Ligji për Organizimin Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2004, 12/2005, 98/2008, 106/2008, 149/2014)
- Ligji për Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2004 dhe 158/2011);
- Ligji për Buxhetet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/05, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16)
- Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Kontabilitet për Buxhetet dhe Përdoruesit e Buxhetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 170/17)
- Ligji për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09, 47/11 dhe 192/15)
- Ligji për Tatimin në Pronë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 61/04, 92/07, 102/08, 35/11, 53/11, 84/12, 188/13)
- Ligji për Taksat Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 61/04, 64/05; 92/07; 123/12)
- Ligji për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13 / 01,24 / 03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06 , 70/06, 92/07, 88 / 08,130 / 08, 6/10, 145/10, 17/11 dhe 84/12)
- Ligji për Bashkëpunimin Ndër-Komunal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2009)
- Ligji për Zhvillimin e Barabartë Rajonal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/2007, 187/2013, 43/2014 dhe 215/2014)
- Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158 // 2010, 187/2013 dhe 43/2014)
- Kodi Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31 / 13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16)
- Ligji për Furnizime Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2007, 130/2008, 97/10, 53/11, 185/11, 15/13, 148/13, 28/14, 43/14, 130/14, 180/14, 78/15, 192/15, 27/16, 120/16 dhe 165/2017)
- Ligji për Koncesione dhe Partneritet Publiko-Privat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15))
- Ligji për Auditimin Shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/2016)
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2001, 78/2001, 04/2002, 59/2002, 05/2003, 84/2008, 81/2009 dhe 151/2009)
- Ligji për Përdorimin dhe Disponimin me Pasuritë në Pronësi Shtetërore dhe me Pasuritë në Pronësi Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.78 / 2015)
- Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera mbi Pasuritë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/01);
- Ligji për Rregullimin e Marrëdhënieve ndërmjet Njësive të Reja të Vetëqeverisjes Lokale dhe Njësive të Vetëqeverisjes Lokale nga të cilat Rrjedhin ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/96).
- Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16 dhe 163/16)
- Ligji për Zbatimin e Planit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë në ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/04);
- Ligji mbi Makinat Kabllore dhe Ashensorët e Skive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/2000, 103/2008, 23/11, 53/11 dhe 163/13)
- Ligji për Rrugët Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2008, 52/2009, 114/2009, 124/10, 23/11, 53/11, 44/12, 168/12, 163/13, 187/13, 39/14, 42/14, 166/14, 44/15, 116/15, 150/15, 31/16, 71/16, 163/16),

23) Dispozitat ligjore dhe nënligjore prej fushës së vetëqeverisjes lokale mund të gjinden në këto faqe të internetit:http://mls.gov.mk/mk/; http://www.finance.gov.mk/mk/ ;http://www.zels.org.mk/и http://www.slvesnik.com.mk/

- Ligji për Përcaktimin e Emrave të Rrugëve, Shesheve, Urave dhe Objekteve të Tjera të Infrastrukturës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/2004, 55/2007, 145/10, 136/11, 163/13 dhe 147/15) ,
- Ligji mbi Tokën Ndërtimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16 dhe 142/16 dhe 190/2016))
- Ligji për Ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137 / 13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15 dhe 226/15, 31/2016)
- Ligji për Mjedisin Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16),
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13 , 41/14, 146/15, 39/16 dhe 63/16),
- Ligji për Cilësinë e Ajrit të Ambientit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2004, 92/2007, 35/2010, 47/2011, 59/12, 163/13, 10/15 dhe 146/15)
- Ligji për Ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2008, 6/2009, 161/2009, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180 / 14,146 / 15 dhe 52/16),
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2007, 124/2010, 47/11, 163/13 dhe 146/15)
- Ligji për Veprimtaritë Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 95/12, 163/13, 42/14, 44/15, 147/15 dhe 31/16)
- Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/2004, 71/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13 , 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 192/15, 39/16 dhe 63/16)
- Ligji për Varrezat dhe Shërbimet e Varrimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 86/2008, 156/10, 53/11, 163/13, 152/15) dhe 31/16)
- Ligji për Shënimin, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave dhe Varreve të Luftëtarëve të Varrosur në Territorin e Republikës së Maqedonisë dhe Jashtë Vendit, si dhe Pjesëtarëve të Ushtrive të Huaja nga Luftërat e Mëparshme në Territorin e Republikës së Maqedonisë("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/96)
- Ligji për Pastërtinë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 111/2008, 64/2009, 88/10, 23/11, 53/11, 80/12, 163/13, 44/15, 147/15, 31/2016 dhe 146/2015),
- Ligji për Furnizimin me Ujë të Pijshëm dhe Kullimin e Ujërave të Ndotura Urbane ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/2004, 28/2006, 103/2008, 17/11, 54/11, 163/13, 10/15 , 147/15 dhe 31/2016),
- Ligji për Menaxhimin e Baterive dhe Akumulatorëve, si dhe Baterive dhe Akumulatorëve për Mbeturina ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/10, 47/11, 148/11, 39/12, 163/13, 146/15 dhe 39/16)
- Ligji për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 38/96, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15 dhe 61/15 dhe 39/16)
- Ligji për Institucionet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/2005, 120/2005 dhe 51/20111)
- Ligji për Qasje të Lirë në Informacionin Publik. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 6/10)
- Ligji për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14")

Botues Qendra për Analiza Ekonomike - CEA
Për botuesin Marjan Nikollov
Titulli **Doracak për kryetarët e komunave dhe anëtarë e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë**
Autorë Mirosllav Trajanovski
Marjan Nikollov
Ana Marija Petrovska
Përkthyes Nadire Latifi
Përpunimi kompjuterik dhe dizajni Mirosllav Millanoviq
Numri i kopjeve 150
Shtypi GLOBAL Comunications

Recensione të doracakut

Prof. d-r Gordana Silanovska – Davkova

Anëtare e Grupit të ekspertëve të pavarur për Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale

RECENSION

Doracakut për kryetarë të komunave dhe anëtarë të këshillave komunalë në Republikën e Maqedonisë nga Mirosllav Trajanovski, Marjan Nikollov dhe Ana Marija Petrovska, CEA (Qendra për analiza ekonomike)

1. Si anëtar shumëvjeçar i Grupit të ekspertëve të pavarur për Kartën Evropiane për vetqeverisje lokale dhe nënkryetar i tij në dy mandate, i gëzohem secilit libër, monografi, doracaku, udhëzuesi, punimi shkencor, kolumne ose shkrimi dedikuar vetqeverisjes lokale dhe demokracisë. Një grup i ekspertëve të pavarur, si mbështetje shkencore dhe profesionale për Kongresin e pushteteve vendore dhe rajonale, është në kontakt të vazhdueshëm me kryetarët e komunave dhe këshilltarët e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, duke i interpretuar dhe mbrojtur parimet e Kartës Evropiane për vetqeverisje lokale. Nga arsyet e lartpërmendura, me kënaqësi iu përvesha rencesimit të këtij doracaku.

2. Ky doracak nuk synon as pretendon t'i mbulojë të gjitha temat dhe pyetjet në lidhje me vetqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë. Autorët janë udhëhequr nga arsye pragmatike: të zgjedhurve të qytetarëve në nivelin lokal, në mënyrë dhe gjuhë të thjeshtë t'ua tregojnë dhe sqarojnë dispozitat më të rëndësishme nga ligjet më të rëndësishme për jetën lokale, pa njohjen e të cilave nuk do të mund në mënyrë të kualifikuar të vendosin për çështje të rëndësisë lokale, por edhe jetësore të qytetarëve. Pra, para nesh gjendet një udhëzues ligjor i llojit të vet, i cili na udhëzon drejt udhës më të shkurtër deri te ligjet dhe normat më të rëndësishme për vetqeverisjen lokale në Maqedoni.

3. Rrugëtimi nëpër normat fillon me dispozitat e Kartës Evropiane për vetqeverisje lokale, si Magna Carta e demokracisë lokale evropiane, e identifikuar në Preambulën e saj si më e afërta për qytetarët. Në 61 faqe tekst, në 12 kapituj, ekzistojnë norma të fushave të ndryshme për të cilat autoritete janë njësitë e vetqeverisjes lokale: e para ka të bëjë me "kornizën legale të LS"; e dyta me "kompetencat e komunave"; e treta me "organet e komunës"; e katërta me "aktet e komunës dhe përgatitjen dhe miratimin e tyre; e pesta me "furnizimet publike dhe partneritetet publike-private"; e gjashta me "pronën komunale"; e shtata me "planifikimin hapësinor dhe urbanistik", e teta me "truallin ndërtimor dhe dhënien e lejeve për ndërtim"; e nënta me "shërbimet komunale"; e dhjeta me "ndërmarrjet publike dhe institucionet publike"; e njëmbëdhjeta me "finansat publike të vetqeverisjes lokale", dhe e dymbëdhjeta me "transparencën fiskale".

4. Autorët kanë bërë prioritizim logjik të ligjeve dhe akteve tjera për vetqeverisjen lokale, përzgjedhje të mire të regullativave relevante ligjore, interpretim të qartë të normave, ndonjëherë të shoqëruara me shembuj relevantë dhe çdoherë me shqyrtim të regullativave.

5. Besoj se Doracaku do të jetë një mjet i dobishëm për kryetarët dhe këshilltarët e komunave në ndërtimin e qëndrimeve dhe në votime. Jam e bindur se do t'iu ndihmojë të orientohen në detin e ligjeve për vetqeverisjen lokale dhe të thirren në të ato të vërtetat. Uroj të thirren në drejtësi, dhe jo në politikë, gjatë procesit të vendimmarrjes, në frymën e mbizotrimit të së drejtës .

6. Nuk ka shkollë më prestigjioze të demokracisë sesa lokalja, prandaj pres që Doracaku të jetë një libër udhëzues të cilin kryetarët dhe këshilltarët e komunave do ta kenë para vetes dhe

Me respekt,

në rolin e recensentes,

Prof. Dr. Gordana Siljanovksa - Davkova

RECENSION

nga Jove Kekenovski, profesor i rregullt në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir, Republika e Maqedonisë, për "Doracakun për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave komunal në Republikën e Maqedonisë" nga autorët Mirosllav Trajanovski, Marjan Nikolov dhe Ana Marija Petrovska

Vetqeverisja lokale është një nga fushat më të rëndësishme të jetës shoqërore në përgjithësi dhe segment i sistemit politik të një shteti. Bëhet fjalë për formë të qeverisjes në bashkësitë lokale në të cilat qytetarët drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve (trupave përfaqësues) dhe organeve tjera lokale, të cilët i zgjedhin ata vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale në fusha të caktuara të jetës shoqërore në bashkësinë lokale. Në Republikën e Maqedonisë së fundmi janë zgjedhur kryetar komunash dhe anëtarë të këshilleve të rinj një njësitë e vetqeverisjes lokale. Për shkak se partitë politike shpesh gjatë kandidimit të kandidatëve për këshilltarë dhe kryetarë komunash nuk mbajnë llogari për njohuritë e tyre elementare rreth vetqeverisjes lokale, për kryerje më efikase të funksionit të tyre paraqitet nevoja për botimin e doracakëve si ky dhe të ngjashëm.

Doracaku për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave komunalë në komunat e Republikës së Maqedonisë nga autorët Misollav Trajanovski, Marjan Nikollov dhe Ana Marija Petrovska, ka për qëllim të kontribuojë në pasurimin teorik dhe empirik të njohurive rreth vetqeverisjes lokale, dhe me këtë të kontribuojë edhe në rritjen e vetbesimit të këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave, në punën e tyre të përditëshme, me qëllim të kryerjes më efikase të obligimeve dhe detyrave të tyre të përditshme. Ky doracak paraqet vegël shtesë dhe mjet për mbështetje të të zgjedhurve lokalë, në të cilin janë elaboruar zgjidhjet ligjore, por gjithashtu janë dhënë njohuri të caktuara, informata dhe ide praktike për realizim të një pjesë te kompetencave të vetqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë.

Doracaku për kryetarët e komunave dhe anëtarët e këshillave komunalë në Republikën e Maqedonisë është i strukturuar në 12 kapituj prej të cilëve, katër të parët përdoruesit i japin mundësi të rrallë e të mirë, në një vend, të njohtohet me kornizën ligjore të vetqeverisjes lokale, me kompetencat dhe organet e njësive në vetqeverisjen lokale, me llojet e akteve që i sjellin organet e njësisë së vetqeverisjes lokale si dhe me procesin e përgatitjes dhe miratimit të tyre. Bëhet fjalë për analizë koncize dhe të përmbledhur të zgjidhjeve ligjore dhe kushtetuese të shtrirjes dhe funksionimit të vetqeverisjes lokale në vendin tonë. Tetë kapitujt e tjerë kanë të bëjnë me përpunimin e vetëm një pjese të kompetencave dhe probleme me të cilat për çdo ditë ballafaqohen përfaqësuesit e zgjedhur në njësitë e vetqeverisjes lokale. Pastaj, vëmendje e posaçme i është kushtuar njërit nga problemeve dhe sfidave më të mëdha, jo vetëm në nivel të vetqeverisjes lokale, por edhe në nivel shtetëror, e ajo është procesi i prokurorimit publik. Prokurorimet publike si formë e pajisjes së organeve kontraktuese me mallra, shërbime ose punë, janë janë nga çështjet më serioze me të cilat vazhdimisht ballafaqohen kryetarët e komunave.

Pikërisht për këtë, kjo pjesë e Doracakut u ofron mundësi të mirë subjekteve përgjegjëse në vetqeverisjen lokale në mënyrë të detajuar të njoftohen me tërë procesin e furnizimit publik. Kapitulli i gjashtë i është dedikuar mundësisë për partneritet publik privat dhe modeleve të këtij partneriteti në vetqeverisjen lokale. Veçanërisht interesante në këtë pjesë të përbajtjes së Doracakut, krahas shtrirjes ligjore të modeleve të partneritetit, është dhënia e disa shembujve për projektet e realizuara deri tani për këtë lloj partneriteti në nivel lokal në shtetin tonë, por edhe fushat ku mund të realizohet partneriteti publik privat në vetqeverisjen lokale në drejtim të motivimit dhe sfidës për kryetarët dhe këshilltarët e sapozgjedhur të komunave. Në këtë pjesë të Doracakut autorët janë përpjekur të japin pasqyrë gjithpërfshirës të pronës së komunës të mënyrave të disponimit dhe përdorimit të pronës, udhëheqjes së regjistrit të pronës komunale, mbrojtjes së pronës si dhe për përgjegjësinë për keqpërdorim të mundshëm të pronës së komunës. Planifikimi hapësinor dhe urbanistik është një nga sfidat më të mëdha të procesit të realizimit të kompetencave të komunës, rregullimi i truallit ndërtimor dhe procesi i dhënies së lejeve për ndërtim, kryerjes së shërbimeve komunale, mundësisë për formim të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike, finansat publike dhe transparenca fiskale e komunave në Republikën e Maqedonisë janë gjithashtu tema të elaboruara në mënyrë serioze dhe kompetenca të vetqeverisjes lokale, të trajtuara në këtë Doracak të çmuar e praktik.

Në përgjithësi, bëhet fjalë për tema të cilat pak janë trajtuar në doracakët e botuar deri tani në vendin to vendin tonë, kurse janë mjaft të rëndësishëm për kryerje efikase dhe efektive të përgjegjësive ligjore të përfaqësuesve të zgjedhur në njësitë e vetqeverisjen lokale.Edhe pse ky Doracak nuk pretendon elaborim gjithpërfshirës (si nga aspekti teorit ashtu edhe nga ai praktik), të kompetencave të njësive të vetqeverisjes lokale, megjithatë temat dhe çështjet e trajtuara janë udhëzues i shkëlqyer për kryetarët dhe këshilltarët në komunat e vetqeverisjes lokale.

Shpresoj dhe uroj që në botimin e ardhshëm autorët te merren me kompetencat, çështjet, temat dhe dilemat e tjera të vetqeverisjes lokale si do të mundnin në këso mënyre bujare të kontribuojnë në ngritjen e nivelit të edukimit dhe efikasitetit të përfaqësuesve lokalë të zgjedhur të popullit, dhe e gjithë kjo të çojë në ngritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve në njësitë e vetqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë.

Me respekt,
Prof d-r JOVE KEKENOVSKI
Profesor i shkencave politike

"Ky doracak nuk synon as pretendon t'i mbulojë të gjitha temat dhe pyetjet në lidhje me vetqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë. Autorët janë udhëhequr nga arsye pragmatike: të zgjedhurve të qytetarëve në nivelin lokal, në mënyrë dhe gjuhë të thjeshtë t'ua paraqesin dhe sqarojnë dispozitat më të rëndësishme nga ligjet më të rëndësishme për jetën lokale, pa njohjen e të cilave nuk do të mund në mënyrë të kualifikuar të vendosin për çështje të rëndësisë lokale, por edhe jetësore të qytetarëve. Pra, para nesh gjendet një udhëzues ligjor i llojit të vet, i cili na udhëzon drejt udhës më të shkurtër deri te ligjet dhe normat më të rëndësishme për vetqeverisjen lokale në Maqedoni".

Prof. d-r Gordana Silanovska-Davkova
Grupi i ekspertëve të pavarur për Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale

"Në përgjithësi, bëhet fjalë për tema të cilat pak janë trajtuar në doracakët e botuar deri tani në vendin to vendin tonë, kurse janë mjaft të rëndësishëm për kryerje efikase dhe efektive të përgjegjësive ligjore të përfaqësuesve të zgjedhur në njësitë e vetqeverisjen lokale. Edhe pse ky Doracak nuk pretendon elaborim gjithpërfshirës (si nga aspekti teorit ashtu edhe nga ai praktik), të kompetencave të njësive të vetqeverisjes lokale, megjithatë temat dhe çështjet e trajtuara janë udhëzues i shkëlqyer për kryetarët dhe këshilltarët në komunat e vetqeverisjes lokale".

Prof. d-r Jove Kekenovski,
Profesor i shkencave politike

Mirosllav Trajanovski është jurist i diplomuar dhe i punësuar si avokat. Punësimi i tij i parë ka qenë në Sekretariatin për ligjvënie, ku ka punuar në përgatitjen e akteve ligjore dhe nënlogjore, dhënien e mendimeve profesionale për të njejtat dhe përgatitijen e opinioneve dhe ekspertizave. Gjatë karrierës së tij si ekspert juridik dhe konsultant, përgatit dhe merr pjesë në përgatitjen e më shumë akteve ligjore, mes të cilave janë Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ligji për për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale. Si zëvendës-lider i ekipit në projektin "Zhvillimi i vetqeverisjes lokale", projekt ky i finansuar nga EAP, përgatit analiza ligjore të cilat kanë të bëjnë me transferin e kompetencave nga niveli qëndror në atë lokal si dhe të ligjeve relevante për kryerjen e kompetencave nga ana e vetqeverisjes lokale. Njëherazi, përgatit dhe implementon trajnime nga fusha e vetqeverisjes lokale. Krahas ekspertizës nga fusha e vetqeverisjes lokale dhe veçanërisht ligjet me të cilat rregullohen aktivitetet komunale, ekspertiza e tij përfshin edhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore nga fusha e prokurorimeve publike dhe partneritetit publiko-privat. Në fushën e partneritetit publiko-privat përgatit doracaqe, mban trajnime, dhe njëherazi përgatit edhe analiza juridike si pjesë përbërëse e studimeve për partneritetin publiko-privat, duke përfshirë edhe marrëveshje që kanë të bëjnë me implementimin e partneritetit publiko-privat në nivel lokal.

Marjan Nikollov është ekspert Global i Partneriteteve Publiko-Private(PPP) me doktoraturë në matjen e efektivitetit të decentralizimit pranë Universitetit të Lubjanës. Ai ka punuar në më shumë se 15 vende në Evropë, Lindje të Mesme dhe Afrikë. Fusha e tij e ekspertizës mbulon financat komunale dhe decentralizimin fiskal, menaxhimin e financave publike, studimet e fizibilitetit të PPP-së, transparencën fiskale dhe monitorimin dhe përgatitjen e analizave të kost-benefiteve. Ai ka zhvilluar, projektuar dhe zbatuar trajnime, hulumtime dhe dokumente për politikëbërësit në fushën e menaxhimit të financave publike dhe decentralizimit. Punimet e fundit kanë të bëjnë me vlerësimin e detyrimeve të komunave në Maqedoni nga ana e projektit të Bankës Botërore përmes Ministrisë së Financave, përgatitjen e dokumentacionit projektues për kërkesën për huamarrje nga ana e komunave nga projekti i Bankës Botërore përmes Ministrisë së Financave, përgatitjen e analizave të kost-benefiteve për zbatimin e GIS në Nairobi/ Keni për Bankën Botërore, trajnimin për ligjvënësit federal irakianë dhe deputetët rajonal kurd në fushën e menaxhimit financiar publik, auditimit dhe buxhetimit për NDI-në amerikane, trajnimin për Ministrinë e Financave dhe Sektorit për Buxhetim të Qeverisë jordaneze në pjesën e përgatitjes së raportit të gjysmë-vjetorit dhe Buxhetit Qytetar, trajnimin për asociacionin e komunave të Tunizisë në fushën e buxhetimit të komunave, trajnim për anëtarët e NALAS-it për veglën për vetë-vlerësimin e kredibilitetit të Bankës Botërore. Mariani ka punuar si hulumtues në Institutin e Islandës dhe ka dhënë mësim në disa universitete private në Maqedoni për më shumë se 10 vjet për lëndë të fushës së financimit të zhvillimit rajonal dhe lokal, statistikë, financat publike të pushtetit lokal dhe matematikë për ekonomistët.

Ana Marija Petrovska është ekonomiste e diplomuar pranë Departamentit të menaxhmentit financiar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Ajo ka punuar si hulumtuese dhe ekonomiste për më shumë se dy vjet dhe gjithashtu ka përvojë si praktikante në sektorë të ndryshëm, siç janë institucionet financiare ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare. Ana Marija ka fituar njohuri të forta për financat publike, procesin e buxhetit lokal, transparencën fiskale dhe llogaridhënien, dhe decentralizimin fiskal. Kontributi i saj pasqyrohet në aftësinë për të analizuar treguesit ekonomik, të dhënat kuantitative dhe kualitative, si dhe hulumtimet e politikave në qeverisjen e mirë dhe decentralizimin. Përgatit dhe moderon grupet e fokusit në fushën e decentralizimit fiskal dhe transparencës fiskale. Në të njëjtën kohë, ka përgatitur dokumente që i referohen decentralizimit fiskal për një zhvillim më të mirë rajonal të shoqërisë civile, transparencës fiskale të komunave në Republikën e Maqedonisë dhe politikën socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë.